



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.
___. ___. 2023

Tiranë, më

VENDIM

Nr. 727, datë 07.12.2023

**PËR
VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, PËR VITIN
2022**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për vitin 2022”, i hartuar nga relatore znj. Brikena Ukperaj,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për vitin 2022”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares {...} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtares bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtares pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1.A Njohuritë ligjore

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave

Në drejtim të përcaktimit të fakteve të çështjes, referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se në bazë të kategorisë së çështjes (*padi themeli ose kërkesë administrative*), gjyqtarja përcakton në fillim të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimit, faktet e çështjes, të cilat kanë rezultuar të provuara nga provat e administruara gjatë gjykimit. Në disa raste, gjyqtarja përpara përcaktimit të fakteve të çështjes pasqyron në mënyrë të detajuar vendimmarrjet e gjykatës për pranimin e kërkesës për saktësim të padisë (*neni 185 të K.Pr.Civile*),¹ shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi (*neni 3/4 të ligjit 49/2012*),² apo për pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë.³

Spikat paraqitja dhe analiza e rrethanave të faktit në mënyrë të qartë, të plotë dhe mbi bazën e renditjes kronologjike. Përshkrimi i rrethanave të faktit të provuara në gjykim bëhet në çdo rast duke i ndërthurur me provat shkresore, aktin e ekspertimit dhe provat e tjera të marrë gjatë gjykimit, duke evidentuar dhe elementët e faktit që kanë rezultuar si të provuar nga vlerësimi tërësor i tyre. Provat e paraqitura nga palët nuk parashtrohen të ndara në vendim, por janë të integruara dhe të evidentueshme në mbështetje të rrethanave të faktit. Elementë të këtyre të fundit, gjenden të pasqyruara dhe në pretendimet e palëve ndërgjyqëse, të evidentuara si të tilla në vendim në një pjesë tjetër të dallueshme për lexuesin. Pas përshkrimit të detajuar të fakteve të çështjes, në të gjitha

¹Vendimi nr.1885, datë 20.06.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

²Vendimi nr.2725, datë 19.10.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

³Vendimi nr.463, datë 21.02.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

vendimet e analizuara, elementë të faktit të provuar bëhen pjesë e analizës ligjore dhe konkluzionit të gjykatës.

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, në të gjitha vendimet e analizuara, gjyqtarja identifikon dhe përcakton natyrën e çështjes objekt shqyrtimi, menjëherë pas paraqitjes së fakteve të çështjes dhe pretendimeve të palëve ndërgjyqëse. Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtarës, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion të saj. Në pjesën e parë përshkruese-arsyetuese gjyqtarja analizon juridiksionin dhe kompetencën e saj (*lëndore dhe tokësore*) për shqyrtimin e çështjes.

Përcaktimi i natyrës së çështjes bëhet duke evidentuar qartë aktin, veprimin, mosveprimin administrativ, si pasojë e të cilit pala paditëse ka ngritur pretendimet objekt padie duke kërkuar sipas rastit, detyrim për dëmshpërblim, pavlefshmërinë absolute ose relative të aktit, shfuqizimin e aktit administrativ dhe detyrimin e organit administrativ për të kryer ose mos kryer një veprim administrativ. Kjo analizë i shërben prezantimit të qartë të natyrës së konfliktit, si dhe orienton në vijim arsyetimin ligjor.

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, në 8 vendimet e vëzhguara, rezulton se pas pasqyrimin të fakteve të çështjeve dhe pretendimeve të palëve në gjykim, gjyqtarja ka identifikuar dhe përcaktuar qartë ligjin e zbatueshëm, duke cituar në përmbajtjen e vendimit dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Administrative, të Kodit të Procedurës Civile, të Kodit Civil që gjejnë zbatim në çështjen konkrete. Konkretisht, në 8 vendimet e analizuara, identifikohen, referohen dhe citohen dispozitat ligjore si më poshtë:

- nenet 7, 8, 10 dhe 11 të ligjit nr.49, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, në lidhje me juridiksionin, kompetencën lëndore dhe tokësor të gjykatës;⁴ nenin 2/2 të ligjit nr.49/2012 dhe nenin 3 të K.Pr.Administrative në lidhje me konceptin e aktit administrativ individual;⁵
- nenin 3, pika 4 të ligjit 49/2012, për shqyrtimin e çështjes mbi bazë aktesh shkresore në dhomë këshillimi; nenin 184, pika 2/b/dh dhe pika 6 të K. Rrugor në lidhje me masat administrative në rastet e drejtimit të mjetit nën ndikimin e alkoolit; nenin 109 të K.Pr.Administrative në lidhje me paligjshmërinë e aktit administrativ; nenin 12 të K.Pr.Civile në lidhje me barrën e provës, nenin 106 të K.Pr.Civile në lidhje me shpenzimet gjyqësore; nenet 37 dhe 40 të ligjit 49/2012 në lidhje me kufijtë e shqyrtimit të çështjes dhe në lidhje me vendimet përfundimtare të gjykatës;⁶
- nenin 317 të K.Pr.Civile në lidhje me dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm;⁷

⁴Dispozitat procedurale lidhur me juridiksionin, kompetencën lëndore dhe tokësore referohen në çdo vendim burim vlerësimi

⁵Vendimi nr.3209, datë 01.12.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

⁶Vendimi nr.2725, datë 19.10.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

⁷Vendimi nr.3227, datë 02.12.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

- nenet 112, 113, 115 dhe, 116 të K.Civil në lidhje me institutin e parashkrimit të padisë, nenin 117 të K.Civil në lidhje me momentin e lindjes së të drejtës së afatit të parashkrimit; nenin 140 të K. Civil në lidhje me prekluzivitetin e së drejtës, nenin 420 të K.Civil në lidhje me burimet e detyrimeve, nenet 608 dhe 609 të K.Civil në lidhje me dëmin jashtëkontraktor, nenin 640 të K. Civil në lidhje me shpërblimin e dëmit pasuror;⁸
- nenet 28, 29 dhe 30 të ligjit 49/2012 në lidhje me kërkesën për sigurimin e padisë, kushtet për sigurimin e padisë dhe llojet e masave për sigurimin e padisë;⁹
- nenin 109 të K.Pr.Administrative në lidhje me paligjshmërinë e akteve administrative;¹⁰
- nenin 510 të K.Pr.Civile në lidhje me titujt ekzekutivë, si dhe nenin 609 të K.Pr.Civile në lidhje me pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv.¹¹

Gjyqtarja identifikon dispozita të ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjeve, si më poshtë:

- nenin 12 të ligjit nr. 75/2014 *“Për shërbimin privat të sigurisë fizike”* në lidhje me kriteret për certifikimin e punonjësit të shërbimit; nenet 2 dhe 3 të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 *“Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret Shtetëror’”* në lidhje me termin “informacion” dhe në lidhje me nivelet e klasifikimit, si dhe Urdhrin nr. 57, datë 28.01.2015 të Drejtorit të Policisë së Shtetit *“Për formën dhe përmbajtjen e vërtetimit të besueshmërisë”*;¹²
- nenin 18 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 *“Për kundërvajtjet administrative”* në lidhje me kriteret për caktimin e llojit dhe masës së dënimit;¹³
- nenin 1 të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”* në lidhje me objektin e ligjit; nenin 3, pikat 1, 2 dhe 3 në lidhje me përkufizimin e “diskriminimit”, “diskriminimit të drejtpërdrejtë” dhe “diskriminimit ndërsektorial”; nenin 33, pika 7/1 në lidhje me barrën e provës, nenin 33, pika 10 në lidhje me përmbajtjen e vendimit të komisionerit, si dhe nenin 33, pika 12 në lidhje me kriteret që duhet të ndjekë komisioneri në përcaktimin e masës që jep nëpërmjet vendimeve të tij; nenin 5, pika 2 të ligjit nr. 10383, datë 24.02.2011 *“Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”* në lidhje me sigurimin e detyrueshëm shëndetësor, si dhe VKM nr. 135, datë 20.02.2013 *“Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë për kryerjen e procedurave të prokurimit, në emër dhe për llogari të institucioneve të varësisë për disa mallra dhe shërbime”*;¹⁴
- nenin 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* i ndryshuar, në lidhje me kompetencat e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale; nenet 1/3, 3, 17, 18 dhe 24,

⁸Vendimi nr.1885, datë 20.06.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

⁹Vendimi nr.125 akti, datë 07.10.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

¹⁰Vendimi nr.3209, datë 01.12.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

¹¹Vendimi nr.463, datë 21.02.2021 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

¹²Vendimi nr.1208, datë 19.04.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

¹³Vendimi nr.2725, datë 19.10.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

¹⁴Vendimi nr.1333, datë 27.04.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

pika 4 dhe 5 të ligjit 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, në lidhje me nxitjen e integritetit, transparencës dhe përgjegjësisë së autoriteteve publike, të drejtën e çdo personi për njohjen me informacionin publik, kufizimin e së drejtës për informim, mënyrën e disponimit të Komisionerit për ankesat e paraqitura dhe në lidhje me kundërvajtjet administrative dhe sanksionet; nenin 16/4 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”* në lidhje me konfidencialitetin; nenin 18 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 *“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”* i ndryshuar, në lidhje me sekretin tregtar, si dhe udhëzimin nr.1284/3, datë 16.03.2005 të Ministrisë të Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë *“Për miratimin e tarifave të shpërblimit të avokatëve për dhënien e ndihmës juridike”*;¹⁵

- nenet 18, 19, 20 dhe 21 të VKM nr.822, datë 07.10.2015 *“Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”*, lidhur me vlerësimin e aplikimit, paraqitjen e dokumenteve të reja dhe me dhënien e miratimit për ndërtim;¹⁶
- nenet 4 dhe 7 të ligjit nr. 8097, datë 21.03.1996 *“Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”*, i ndryshuar, në lidhje me përfitimet suplementare; nenin 1/9/a në lidhje me termin *“Grup i dytë”*, si dhe nenin 19 në lidhje me mosparashkrueshmërinë e së drejtës për përfitim të pagesës kalimtare; nenin 65 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 *“Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar, në lidhje me fondin e sigurimeve shoqërore; nenet 1, 2/gj dhe 21 të ligjit 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”* në lidhje me objektin e ligjit, termin magjistrat dhe në lidhje me pensionin suplementar dhe përfitimet e tjera të magjistratëve si dhe VKM nr. 548, datë 27.07.2016 *“Për miratimin e kriterëve rregullave dhe të procedurave për përfitimin e pensioneve shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”*.¹⁷

Krahas dispozitave dhe ligjeve të posaçme si më sipër, gjyqtarja ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe dispozita të Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës:

- nenin 30 të Kushtetutës në lidhje me parimin e prezumimit të pafajësisë;¹⁸
- nenin 6 të KEDNJ dhe nenin 42 të Kushtetutës në lidhje me të drejtën për një proces të rregullt ligjor, nenin 142/3 të Kushtetutës në lidhje me detyrimin për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore;¹⁹
- nenin 26 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, nenet 13 dhe 14 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, nenin 10 të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Gruas, nenet 28 dhe 29 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës, nenin 2

¹⁵Vendimi nr.3227, datë 02.12.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

¹⁶Vendimi nr.1885, datë 20.06.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

¹⁷Vendimi nr.3209, datë 01.12.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

¹⁸Vendimi nr.1208, datë 19.04.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

¹⁹Vendimi nr.463, datë 21.02.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

Protokollin i 1 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Fundamentale të Njeriut, nenin 13 i Protokollit Shtesë të Konventës Amerikane për të Drejtat e Njeriut dhe nenin 17 të Kartës Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve, në lidhje me të drejtën për arsimim;²⁰

- nenin 18 të Kushtetutës në lidhje me parimin e barazisë para ligjit dhe ndalimin e diskriminimit, nenin 54 dhe 59/1/ç të Kushtetutës në lidhje me mbrojtjen e veçantë të fëmijëve, nenin 14 të KEDNJ në lidhje me ndalimin e diskriminimit, nenin 24 të Konventës “Për të drejtat e fëmijës” në lidhje me të drejtën e fëmijëve për shëndet;²¹
- nenin 19 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, nenin 10 të KEDNJ, nenin 11 të Deklaratës së KE-së mbi të Drejtën e Informimit, Rekomandimin e Këshillit të Europës mbi të Drejtën e Informimit për Dokumentet Zyrtare, Kartën Evropiane të të Drejtave Themelore, si dhe Rregulloren nr. 1049/2001 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit në lidhje me të drejtën për informim,²² nenin 255 të Traktatit Themelues të Bashkimit Evropian në lidhje me parimin e transparencës, nenin 5/2 dhe 6/3 të KEDNJ dhe nenet 28 dhe 31 të Kushtetutës në lidhje me të drejtën e informimit të personit të cilit i është kufizuar liria personale apo është në proces penal, nenin 15 të Kushtetutës në lidhje me parimin se të drejtat dhe liritë themelore janë të padhunueshme, nenin 23 të Kushtetutës në lidhje me të drejtën e informimit, nenin 116 të Kushtetutës në lidhje me hierarkinë e normave ligjore, Direktivën 95/46 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit datë 24 tetor 1995 “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, si dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave”.²³

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtarja ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në një rast konkret. Nga ana tjetër, nuk konstatohet ndonjë rast ku analiza e konfliktit të normave të ketë qenë e domosdoshme, në mbështetje të arsytimit lidhur me zgjidhjen e çështjes.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, spikat aftësia e gjyqtarës për identifikimin e qartë, të saktë dhe të kuptueshëm të fakteve të çështjes, proces në të cilin ajo arrin nga një analizë e integruar më vete dhe në tërësi e provave, pavarësisht pretendimeve të palëve mbi rrethanat e faktit. Identifikimi i natyrës së marrëdhënies juridike, duke i paraprirë në çdo rast analizës së fakteve të provuara, orienton jo vetëm linjën e mëpasshme të arsytimit të vendimit, por edhe lexuesin në kuptueshmërinë e asaj çka është vendosur. Gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në

²⁰Vendimi nr.125 akti, datë 07.10.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

²¹Vendimi nr.3227, datë 02.12.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

²²Gjithashtu, citon edhe dokumentet e para ku rezultojnë të jetë përmendur e drejta e informimit, p.sh Kartën e të Drejtave në Angli (viti 1688), Deklaratën Franceze të të Drejtave të Njeriut dhe Qytetarit (viti 1789), Amendamentin e Parë të Kushtetutës së SHBA.

²³Vendimi nr.1333, datë 27.04.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale të akteve ligjore dhe nënligjore që gjejnë zbatim mbi faktin objekt shqyrtimi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore referohen ose citohen duke u shoqëruar në çdo rast me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes, si në ato me natyrë procedurale ashtu edhe në ato që kanë lidhje me themelin e çështjes. Tipar karakteristik i gjyqtarës është se citimi ose referimi i dispozitave, kryesisht atyre që aplikohen drejtpërdrejt për zgjidhjen në themel të çështjes, është shoqëruar me interpretimin e tyre para aplikimit mbi faktin konkret. Gjyqtarja kryesisht përdor interpretimin *teleologjik* të normës konkrete duke identifikuar qëllimin e saj, por edhe interpretimin *literal* dhe *sistematik* të normave, duke përqasur kuptimin e normës me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara.

Në lidhje me dispozitat materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes evidentohet se interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin teorik të saj, duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative ose alternative, që të gjejë zbatim norma konkrete, por edhe në përputhje me faktin dhe provat e administruara në gjykim. Konkretisht:

- interpreton në mënyrë literale nenin 3, pika 1 dhe 2 të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në lidhje me diskriminimin e drejtpërdrejtë, duke evidentuar elementët që duhet të verifikohen në mënyrë kumulative, analizon konceptin e barrës së provës në çështjet e diskriminimit duke interpretuar nenin 33, pika 7/1 të ligjit 10221/2010;²⁴
- interpreton nenin 16, pika 4 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publiket” në funksion të kualifikimit të dokumentacioni si sekret tregtar, nenin 18 të ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, në lidhje me mbrojtën e të dhënave të cilësuar si sekret tregtar, nenin 17/2 të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit” në lidhje me elementet që duhet të ekzistojnë në njëkohësisht që të kufizohet dhënia e informacioni;²⁵
- interpreton nenin 608 të K.Civil në funksion të trajtimit të elementëve të padisë së kërkimit të dëmit jashtëkontraktor, duke përcaktuar kushtet për pasjen e dëmit jashtëkontraktor, e përkatësisht faktin e paligjshëm, dëmin e paligjshëm, lidhjen

²⁴Vendimi nr.1333, datë 27.04.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

²⁵Vendimi nr.3227, datë 02.12.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

- shkakësore dhe fajin, duke u ndalur në analizën e detajuar të konceptit të dëmit të paligjshëm. Lidhja shkakësore është një kusht tjetër i domosdoshëm për të ekzistuar dëmi jashtëkontraktor dhe në këtë kuadër me qëllim përcaktimin e kriterëve që duhet të ekzistojnë së bashku që të ekzistojë lidhja shkakësore (*i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm*) gjyqtarja interpreton nenin 609 të K.Civil,²⁶
- interpreton nenin 21/1, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” në lidhje me përfitimet suplementare të magistratëve dhe nenin 1/9/a të ligjit nr. 8097/1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit” , të ndryshuar në lidhje me termin “*Grup i dytë*”, duke zgjidhur konfliktin që krijohet në dukje ndërmjet tyre, duke mbajtur në konsideratë edhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese për këtë qëllim;²⁷
 - identifikon kriteret për çertifikimin e punonjësit të shërbimit referuar nenit 12 të ligjit nr. 75/2014 “*Për shërbimin privat të sigurisë fizike*”, duke evidentuar dhe trajtuar specifikisht kriterin e besueshmërisë.²⁸

Në lidhje me normat procedurale, gjyqtarja ka interpretuar dispozitat në disa raste, si më poshtë:

- Trajton parimin procedural të barrës së provës, duke evidentuar rregullin e përgjithshëm sipas nenit 12 të K.Pr.Civile, e më pas rregullimin e posaçëm referuar parashikimeve të ligjit të posaçëm nr. 49/2012;²⁹
- interpreton në mënyrë literale nenet 28 dhe 29 të ligjit 49/2012, në funksion të analizës juridike të konceptit të sigurimit të padisë, duke sqaruar kuptimin, karakteristikat dhe kushtet ligjore në lidhje me to;³⁰
- Trajton aktin administrativ individual duke sjellë në vëmendje parashikimin e nenit 2/2 të ligjit nr. 49/2012, të ndryshuar dhe nenit 3 të K.Pr.Administrative në lidhje me konceptin e aktit administrativ individual, si dhe doktrinës juridike;³¹
- interpreton nenin 317 të K.Pr.Civile në lidhje me kërkesën për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm;³² etj.

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, nga tërësia e vendimeve burim vlerësimi, rezulton se gjyqtarja zbaton *parimin e procesit të rregullt ligjor*, pasi referuar kontekstit të arsytimit të vendimeve, rezulton të jenë zbatuar drejtpërdrejt aspekte të tij në lidhje me respektimin e të drejtave procedurale të palëve ndërgjyqëse, aksesin në gjykatë, kontradiktorialitetin, të drejtën e disponimit të padisë, barrën e provës, fuqinë provuese të provave të administruara në gjykim, etj. Në vendimet burim vlerësimi ka analizë të *parimit procedural të barrës së provës*, parim i cili referohet dhe analizohet në çdo vendim burim vlerësimi. Ky parim referohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke përcaktuar në mënyrë të shprehur barrën e provës, në

²⁶Vendimi nr.1885, datë 20.06.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

²⁷Vendimi nr.3209, datë 01.12.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

²⁸Vendimi nr.1208, datë 19.04.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

²⁹Vendimi nr.2725, datë 19.10.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

³⁰Vendimi nr.125 akti, datë 07.10.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

³¹Vendimi nr.3209, datë 01.12.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

³²Vendimi nr.3209, datë 01.12.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

raport me parashikimet e ligjit të posaçëm nr.49/2012, si dhe duke analizuar lidhur me mënyrën e zbatimit të tij referuar natyrës së çështjes. Po ashtu, referohet dhe analizohet parimi i prezumimit të pafajësisë, si dhe parimi se çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit;³³ parimin e shtetit të së drejtës, të gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, si dhe të proporcionalitetit;³⁴ parimi i sigurisë juridik;³⁵ parimin e epërsisë së ligjit, të gjykimit të drejtë, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, si dhe parimin e barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit;³⁶ etj.

Në lidhje me aftësinë për të përdorur jurisprudencën relevante, rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur gjerësisht jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ*), në mbështetje të argumenteve të saj në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, kryesisht në rastet si më poshtë:

- vendimin e GJEDNJ “*Sampanis kundër Greqisë*” në lidhje me lënien e mundësisë së shteteve për të rregulluar situatën e cila ka shkaktuar diskriminimin; jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, përkatësisht vendimin nr. 5/2011 në lidhje me doktrinën e hapësirës së vlerësimit, si dhe vendimet nr. 39/2007, nr. 4/2010 dhe nr. 34/2015 në lidhje me parimin e barazisë para ligjit;³⁷
- vendimet e GJEDNJ “*Appleby dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*” dhe “*Ozgur Gundem kundër Turqisë*” në lidhje me balancën midis interesit publik dhe atij të individit;³⁸
- vendimet e GJEDNJ “*Hornsby kundër Greqisë*”, “*Geogiadis kundër Greqisë*” dhe “*Hasan dhe Chaus kundër Bullgarisë*”, në lidhje me të drejtën për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë si pjesë integrale e nenit 6 të KEDNJ; vendimet nr. 43/2007, 1/2009 dhe 6/2009 të Gjykatës Kushtetuese, në lidhje me rëndësinë e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë; vendimin nr.459, datë 14.12.2010 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në lidhje me padinë për goditjen e titullit ekzekutiv;³⁹
- vendimin nr.30, datë 07.02.2017 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë në lidhje me të drejtën e ankimit;⁴⁰
- vendimin unifikues nr. 10/2004 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në lidhje me sigurimin e padisë;⁴¹
- vendimin nr. 34/2017 të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me ligjin nr. 96/2016“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vendimin nr. 78/2017 në lidhje me ligjin 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe vendimet nr. 19/2007 dhe nr. 2/2010 në lidhje me zgjidhjen e konflikteve midis ligjeve.⁴²

³³Vendimi nr.1208, datë 19.04.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

³⁴Vendimi nr.2725, datë 19.10.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

³⁵Vendimi nr.125 akti, datë 07.10.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

³⁶Vendimi nr.1333, datë 27.04.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

³⁷Vendimi nr.1333, datë 27.04.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

³⁸Vendimi nr.3227, datë 02.12.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

³⁹Vendimi nr.463, datë 21.02.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

⁴⁰Vendimi nr.2725, datë 19.10.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

⁴¹Vendimi nr.125 akti, datë 07.10.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

⁴²Vendimi nr.3209, datë 01.12.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

KONKLZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjet procedurale të analizuara, ashtu edhe në lidhje me zgjidhjen në themel të mosmarrëveshjeve objekt gjykimi. Dispozitat e ligjit material rezulton të jenë referuar dhe interpretuar në mënyrë konsistente, duke i zërthyer paraprakisht në elementë përbërës të tyre, duke identifikuar qëllimin dhe funksionin e dispozitës para aplikimit të saj mbi faktet e çështjes konkrete. Evidentohet kujdesi i gjyqtarës për të referuar, zbatuar dhe kur është rasti për të analizuar aspekte të procesit të rregullt ligjor, posaçërisht lidhur me elementin e barrës së provës, si dhe për të referuar parime të tjera procedurale dhe materiale, në mbështetje të interpretimit të dispozitave ligjore të zbatueshme. Në disa nga çështjet brumi vlerësimi, gjyqtarja ka referuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.B Arsyetimi ligjor

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtarja gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe vendimet përfundimtare është e thjeshtë, e drejtpërdrejtë, e qartë dhe e kuptueshme për pjesëmarrësit në proces, si dhe për lexuesin.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës apo parimeve të përgjithshme të së drejtës procedurale dhe materiale, evidentohet përdorimi i termave/shprehjeve në gjuhën latine, përgjithësisht të etiketuar (në kllapa), duke u shoqëruar gjithmonë me dhënien e kuptimit të termit/shprehjes përkatëse në gjuhën shqipe, pa krijuar konfuzion për përmbajtjen apo kuptimin e tyre.⁴³ Termat teknikë janë përdorur në mënyrë korrekte dhe vetëm në rastet kur përdorimi i tyre është i pashmangshëm, duke iu referuar ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme që zbatohen mbi marrëdhënien objekt gjykimi.

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve apo shprehjeve që mund cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyjes apo denigrues.

⁴³P.sh: *de facto; in dubio pro reo; ratio legis; fumus boni iuris; alterum non laedere; neminem laedere; lex aquila de damno; restitutio in integrum; status quo ante etj.*

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Në të gjitha vendimet gjyqësore rezulton përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip. Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës, paragrafët apo nënndarjet e arsyetimit të vendimit gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi, në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren.

Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare dhe në disa raste edhe fjali më të gjata, si pasojë e vazhdimësisë së mendimit juridik të shprehur, por kjo nuk krijon paqartësi, pasi në çdo rast rezulton se mendimi është shprehur në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme, duke organizuar fjalitë, paragrafët dhe nënndarjet e arsyetimit të vendimit, në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës.

Mënyra e organizimit dhe shprehjes së mendimit në arsyetimin e vendimeve dhe përdorimi i një gjuhe të qartë dhe të drejtpërdrejtë, përzgjedhja e fjalëve, organizimi i tyre në fjali dhe më pas në paragrafë të lidhur me njëri tjetrin sipas linjës së arsyetimit të vendimeve, i bën në tërësi vendimet të kuptueshme, duke mos lënë hapësirë për kuptim të gabuar apo të ndryshëm të mendimit të shprehur.

Në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë së vendimit, veç pjesës hyrëse dhe përshkruese arsyetuese të vendimit, evidentohet se në dispozitivin e vendimit gjyqtarja shprehet në mënyrë të plotë dhe koncize për të gjitha kërkimet e objekti të padisë në rastet e pranimit të saj, për cilësinë e vendimit si titull ekzekutiv, shpenzimet gjyqësore, të drejtën e ankimit, afatin e ankimit dhe momentin e fillimit të tij në rastet kur vendimi është i ankimeshëm.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Gjuha e përdorur dhe mënyra e organizimit të mendimit, mundësojnë lexim të organizuar që ofron kalime nga njëra pjesë e vendimit tek tjetra, në mënyrë logjike. Paragrafët përgjithësisht fillojnë me një fjali tematike, e cila përmbledh përmbajtjen e tij dhe shpreh idenë kryesore të mendimit të asaj njësie. Kjo mënyrë e të shkruarit i shërben jo vetëm qartësisë dhe kuptueshmërisë së vendimit, pa përsëritje dhe rikthim në çështje të analizuara më parë, por siguron qëndrueshmëri të mendimit, pa ndërprerje të tij dhe e bën mendimin të rrjedhë natyrshëm, si një i tërë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, konstatohet se gjyqtarja ndjek në hartimin e vendimeve gjyqësore të njëjtën strukturë, e cila është qëndrueshme, e organizuar dhe e standardizuar. Vendimet gjyqësore *përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkuese-arsyetuese, si dhe dispozitivin*, sipas parashikimeve të nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile dhe neneve 40 dhe 41 të ligjit të posaçëm nr.49/2012, i ndryshuar.

Në *pjesën hyrëse* të vendimit gjen pasqyrim trupi gjykues që ka dhënë vendimin, sekretarja gjyqësore, data e shqyrtimit, palët ndërgjyqëse (*me të dhënat për gjeneralitetet, adresën dhe përfaqësimin në gjykatë, prezenca ose mungesa e tyre në seancë*), objekti i mosmarrëveshjes administrative dhe kërkimet përfundimtare të palëve ndërgjyqëse.

Pjesa përshkuese-arsyetuese është e ndarë në disa pjesë në të cilën në mënyrë të detajuar gjyqtarja ndalet në:

- (i) Analizën dhe vlerësimin kryesisht të çështjeve të juridiksionit, kompetencës, si dhe në evidentimin e vendimeve të ndërmjetme të gjykatës gjatë procesit si p.sh. kërkesa për marrjen e masës së sigurimit të padisë, saktësimin e objekti të padisë, etj.
- (ii) *Faktet dhe rrethanat e provuara në gjykim*, pjesë në të cilën rezulton se gjyqtarja përshkruan në mënyrë të detajuar dhe kronologjike faktet e çështjes, integruar me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim;
- (iii) *Pretendimet dhe prapësimet e palëve*, pjesë në të cilën gjyqtarja pasqyron në mënyrë të përmbledhur pretendimet dhe prapësimet e secilës palë, duke integruar dhe provat përkatëse mbi të cilat mbështeten pretendimet e tyre;
- (iv) *Analizën ose vlerësimin ligjor* të gjykatës lidhur me çështjen. Pas evidentimit dhe analizës së elementëve procedurale, fakteve të çështjes dhe pretendimeve të palëve, arsyetimi vijon me një nënndarje përgjithësisht të titulluar “Arsyetimi ligjor”, në të cilin, gjyqtarja fillimisht a) citon ligjin material e procedural që zbatohen në çështjen konkrete, duke i referuar dispozitat materiale administrative dhe civile, por edhe ato të ligjit të posaçëm në të cilën të referon fakti juridik; b) merr në analizë ligjin e zbatueshëm, duke bërë interpretimin e tij, para aplikimit mbi faktet konkrete; c) për të përfunduar me një përmbledhje dhe konkluzion mbi çështjen.

Në *pjesën e dispozitivit* gjen pasqyrim disponimi i gjykatës, i cili është rrjedhojë e analizës së kryer nga gjykata në pjesën përshkuese–arsyetuese. Është disponuar për pranimin ose rrëzimin e padisë dhe mbi barrën e shpenzimeve gjyqësore. Disponohet gjithashtu për të drejtën e ankimit sipas afateve ligjore.

KONKLUZIONI

Sa më sipër, rezulton se gjyqtarja ndjek një strukturë të njëjtë në arsyetimin e vendimeve, duke ndarë në mënyrë të diferencuar vizualisht dhe logjikisht çdo komponent përbërës, mbi bazën e të cilit ajo trajton çështjet në mënyrë të organizuar.

Kjo mënyrë e standardizuar e të shkruarit të vendimit gjyqësor, orienton lehtësisht lexuesin dhe i shërben kuptueshmërisë së logjikës juridike për atë që është konkluduar.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme. Arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitiv të vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GJEDNJ është shprehur se, megjithëse gjykatave u lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përse u përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për t’u ankuar.⁴⁴

- Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Vendimet gjyqësore dominohen nga procesi analitik dhe vlerësues në raport me atë përshkruar të fakteve dhe provave. Gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në paraqitjen dhe analizën e fakteve të çështjes, analizë e cila në vendimet gjyqësore burim vlerësimi është e detajuar dhe e plotë, duke integruar si pjesë të saj provat mbi të cilat mbështetet konkluzioni për provueshmërinë e fakteve konkrete.

Në secilin vendim, duke iu referuar natyrës komplekse ose jo të faktit, si dhe kategorisë së çështjes apo llojit të vendimit, analiza ligjore zhvillohet në mënyrë logjike. Jepen argumente për secilin kërkim objekt padie, duke u ndaluar në interpretimin e ligjit dhe mënyrën e aplikimit të tij mbi faktet konkrete, si dhe lidhjen shkak- pasojë mes fakteve të provuara në gjykim, interpretimit të ligjit dhe konkluzioneve të arritura.

Në të gjitha vendimet e analizuar, rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, gjithmonë i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin, pretendimin e ngritur, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale. Arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe atë material. Evidentohet kujdesi i gjyqtarës në arsyetim për të identifikuar dhe analizuar konceptet ligjore në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes. Gjyqtarja evidenton në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme

⁴⁴Vendimi i GJEDNJ, çështja *Hadjanastassiouvs Greqisë*, datë 16.12.1992, fq. 33

thelbin e konfliktit objekt gjykimi duke orientuar analizën e koncepteve ligjore në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes.

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, rezulton se ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor. Shpjegimet dhe prapësimet parashtrohen fillimisht në mënyrë të detajuar në pjesën e parë të arsyetimit, ndërsa më pas merren në analizë më vetë, të ndërthurura me analizën e provave dhe zbatimin e ligjit. Pretendimet e palëve, marrin një përgjigje të argumentuar në aspektin e mbështetjes në ligj apo prova të tyre.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Gjyqtarja analizon konceptet ligjore që i shërbejnë zgjidhjes së çështjes mbi bazën e një zhvillimi dhe argumenti logjik. Në këtë kontekst vlerësohet një shkallë shumë e lartë kujdesi e gjyqtares për identifikimin e marrëdhënies shkak-pasojë dhe zbatimin e dispozitave ligjore mbi një situatë të caktuar. Në tërësi në vendimet e vëzhguara gjyqtarja e shoqëron analizën e saj juridike me praktikën gjyqësore. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë duke marrë në analizë të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse, në përmbushje të standardit të procesit të rregullt ligjor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtarja përdor kohën e saj si kur gjykon e vetme, ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A Aftësia e gjyqtares për të përballuar ngarkesën në punë

2.A.a Respektimi i afateve ligjore

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit viti 2022, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjithsej 17 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, të cilat i përkasin dy kategorive, “Administrative me palë kundërshtare” dhe “Administrative pa palë kundërshtare”. Duke iu referuar objektit të çështjeve pasqyruar në tabelat me të dhëna statistikore, rezulton se çështjet janë me objekt “Kundërshtim i veprimeve përmbaremore” për të cilat neni 610 paragrafi i tretë⁴⁵ i Kodit të Procedurës Civile, parashikon se çështja duhet të shqyrtohet brenda një afati 20 ditor; me objekt “Sigurim padie”, të cilat sipas parashikimeve të nenit 28, pika 3⁴⁶ të ligjit nr.49/2012 duhet të shqyrtohen brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes në gjykatë dhe me objekt “Ndihmë juridike” për të cilat nenin 22 i ligjit 111/2017 parashikon se kërkesa duhet të shqyrtohet brenda 5 ditëve.⁴⁷

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nga 17 çështje për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, 10 prej tyre janë shqyrtuar në tejkalim të këtij afati. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (10 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (17 çështje), **sipas një analize vetëm matematikore, gjyqtarja rezulton që të ketë gjykuar 58.8% të çështjeve jashtë afatit ligjor.**

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit në lidhje me respektimin e afateve ligjore gjyqtarja ka parashtruar si shkaqe për tejkalimin e tyre:

- Gjykimi administrativ është një gjykim i bazuar mbi akte shkresore dhe rregullohet përveçse nga dispozitat e Kodit të Procedurës Civile edhe nga Ligji 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar. Në këtë ligj janë përcaktuar disa rregulla specifike qëllimi i të cilave ka qenë shpejtësia e këtij lloj gjykimi.
- Pavarësisht këtyre rregullave procedurale nuk është e thjeshtë për gjykatën që të kryejë një gjykim të shpejtë pasi shpesh sjellja e organeve publike, që janë të ngarkuar me barrën e provës në këtë gjykim, nuk është në përputhje me detyrimet ligjore, sipas LGJA-së. Organet publike shpesh pësojnë ndryshime strukturore dhe funksionale, që passjell vonesa në gjykim, pasi vjen për pasojë kryerja e veprimit procedural të kalimit procedural, ndryshimi i përfaqësuesve ligjorë, apo urdhërimi kryesisht të paraqitjes së

⁴⁵Neni 69 i ligjit nr. 49/2012 parashikon se “Veprimet e kryerja nga përmbareuesi gjyqësor, në kundërshtim me masat apo urdhrat e gjykatës, ankimohen sipas parashikimeve të nenit 610 të Kodit të Procedurës Civile”. Ndërkohë neni 601, paragrafi 3 i K.Pr.Civile parashikon se: “Ankimi shqyrtohet **brenda 20 ditëve** nga gjykata e vendit të ekzekutimit, e cila kur e sheh të nevojshme mund të thërrasë palët dhe përmbareuesin gjyqësor”.

⁴⁶Neni 28, pika 3 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” parashikon se: “3.Kërkesa për sigurimin e padisë, sipas pikave 1 dhe 2 këtij neni, duhet të shqyrtohet **brenda 5 ditëve** nga data e paraqitjes në gjykatë. Si rregull kërkesa shqyrtohet në prani të palëve, por, në rastet e ngutshme, mund të shqyrtohet edhe pa u thirrur palët”.

⁴⁷Neni 22, i ligjit 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” parashikon: “Gjykata shqyrton kërkesën për ndihmën juridike detyësore në përputhje me parashikimet në legjislacionin procedural dhe, për aq sa është e mundur, me dispozitat e këtij ligji. 2. Vendimi në lidhje me kërkesën për ndihmë juridike detyësore merret nga gjykata kompetente: a) **brenda 5 ditëve** nga data e regjistrimit të kërkesës, kur kërkesa paraqitet përpara fillimit të procesit gjyqësor...”

akteve shkresore apo provave, etj. Shpesh herë, organet publike nuk paraqesin prova apo informacionin e nevojshëm për Gjykatën apo e lënë gjykimin në mungesë, ndaj në mënyrë që të arrihet balanca e duhur midis detyrimit për të kryer një hetim gjyqësor të plotë dhe të gjithanshëm dhe detyrimit për gjykimin brenda afateve të shpejta, veprohet me marrjen e tyre kryesisht, për këtë shkak ndodh shtyrja e gjykimit, etj.

- Gjatë punës time, në mënyrë që të përfitojë sa më shumë kohë marr masa që çështja e caktuar për gjykim me short të verifikohet po atë ditë për mangësi apo plotësim të akteve. Ky verifikim i shpejtë më jep mundësinë që të planifikoj me efektivitet veprimet e tjera procedurale.
- Po kështu për të shmangur çdo vonesë, kam përpiluar modele të akteve të gjykimit të standardizuara që disa veprime procedurale të kryhen me shpejt. Për njoftimin e palëve ndërgjyqëse apo plotësimin e të metave përdoren mjete dhe metoda të shpejta si email, telefoni, apo të dhënat zyrtare elektronike, pranë institucioneve të ndryshme, siç mund të jetë QBK-ja, listat elektronike të ekspertëve, etj.

Në detyrën e vlerësuesit është bërja e analizës së të dhënave statistikore në mënyrë të tillë që të shmangen përfundime që vijnë për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Për analizën e këtij treguesi, vlerësuesi nuk bazohet vetëm në të dhënat statistikore, por merr në konsideratë të gjitha të dhënat e burimeve të tjera të vlerësimit. Duke iu referuar tabelave me të dhëna statistikore, për 10 çështjet e shqyrtuara jashtë afatit ligjor, rezultojnë se çështjet me objekt “*Kundërshtim veprimesh përmbarimore*”, përbëjnë 5 çështje⁴⁸ (çështje të pasqyruara në tabelën nr.1), të cilat respektivisht janë gjykuara për 2 muaj e 3 ditë, 2 muaj e 24 ditë, 1 muaj e 20 ditë, 26 ditë dhe 2 muaj e 12 ditë (në një tejkallim nga 6 ditë – 64 ditë nga afati 20 ditor i parashikuar në ligj).

Referuar tabelës me të dhëna statistikore, rezultojnë se disa nga çështjet i kanë kaluar gjyqtarës me short në një kohë të mëvonshme nga data e regjistrimit. Konkretisht:

- Çështja me nr. rendor 83, me nr.5320/1406 regjistri, rezultojnë se ajo është regjistruar në datë 21.12.2021 por i ka kaluar gjyqtarës me short në datë 03.02.2022 dhe ka përfunduar me vendimin nr. 1329, datë 27.04.2022, për një afat prej 83 ditësh, duke u përlllogaritur ky afat nga dita e caktimit të çështjes me short.
- Çështja me nr. rendor 120, me nr.2915 regjistri rezultojnë se është regjistruar në datë 26.04.2022 por i ka kaluar gjyqtarës me short 27.04.2022 dhe ka përfunduar me vendimin nr.1858, datë 14.06.2022, për një afat prej 47 ditësh, duke u përlllogaritur ky afat nga dita e caktimit të çështjes me short.
- Çështja me nr. rendor 174, me nr.4766 regjistri rezultojnë se është regjistruar në datë 14.10.2022 por i ka kaluar gjyqtarës me short 17.10.2022 dhe ka përfunduar me vendimin nr. 2958, datë 08.11.2022, për një afat prej 22 ditësh, duke u përlllogaritur ky afat nga dita e caktimit të çështjes me short.
- Çështja me nr. rendor 188, me nr.4520 regjistri, rezultojnë se ajo është regjistruar në datë 20.09.2022 por i ka kaluar gjyqtarës me short në datë 10.10.2022 dhe ka përfunduar me vendimin nr. 3186, datë 30.11.2022, për një afat prej 51 ditësh duke u përlllogaritur ky afat nga dita e caktimit të çështjes me short.

⁴⁸Të dhënat për kohëzgjatjen e gjykimit për çështjet e pasqyruara në tabelën nr. 1, me nr. rendor 62, 83, 120, 174 dhe 188.

Në lidhje me afatin e gjykimit në çështjet me objekt “*Kundërshtim veprimesh përmbaremore*” neni 610 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se ato shqyrtohen brenda 20 ditëve, në dhomë këshillimi dhe kur e vlerëson të arsyeshme, gjykata mund të thërrasë palët. Pavarësisht mënyrës së shqyrtimit, në dhomë këshillimi apo në seancë, gjykatës i duhet të kryejë disa veprime procedurale për të respektuar të drejtat e palëve në proces, duke kryer të paktën veprimet e mëposhtme:

- njoftimin e ankuesit për të plotësuar të metat e ankimit, nëse konstatohen të tilla dhe lënien e afatit deri në 10 ditë sipas parashikimeve të nenit 25, pika 1, shkronja “a” të ligjit nr.49/2012;
- njoftimin e ankimit dhe akteve shoqëruese përmbareuesit gjyqësor dhe lënien e afatit deri në 10 ditë për depozitimin e prapësimeve me shkrim dhe provave, sipas parashikimeve të nenit 25, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr.49/2012;
- caktimin e seancës dhe njoftimin e palëve për datën dhe orën e zhvillimit të gjykimit, duke respektuar një afat minimal për të mundësuar kryerjen e njoftimit prej 5 ditësh para seancës, nëse çështja do të shqyrtohet duke thirrur palët për t’u dëgjuar në seancë.

Vetëm me kryerjen e këtyre veprimeve minimale dhe të domosdoshme për të respektuar të drejtat e palëve në proces, pa përlllogaritur kohën e nevojshme për dërgimin e njoftimeve për plotësimin e të metave të padisë dhe për dërgimin e njoftimit për përmbareuesin gjyqësor për paraqitjen e prapësimeve dhe provave, afati ligjor 20 ditor i gjykimit do të rezultonte i tejkaluar. Ndërkohë që ligjvënësi, ndërsa për gjykatën e shkallës së parë që shqyrton ankimin në themel ka parashikuar afatin 20 ditor të shqyrtimit, për gjykatën e apelit që shqyrton ankimin ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, mbi shkaqet e ankimit dhe kryesisht duke u bazuar në aktet e dosjes, ka parashikuar në nenin 610 një afat më të gjatë gjykimi prej 30 ditësh ose 45 ditësh, në rast se gjykata vlerëson të nevojshëm shqyrtimin e çështjes me praninë e palëve, kur janë rastet e parashikuara nga ligji.

Nëse afati ligjor i shqyrtimit të çështjeve me këtë objekt, do të ishte i njëjtë me afatin maksimal që K.Pr.Civile parashikon për shqyrtimin e çështjes në gjykatën e apelit, afati do të konsideroj i tejkaluar vetëm në 4 çështje, të cilat janë shqyrtuar përkatësisht për 62, 83, 47 dhe 51 ditë.

Në çështjet me objekt “*Sigurim padie*”, nga 5 çështje, rezultojnë se 2 çështje janë gjykuar jashtë afatit 5 ditor,⁴⁹ të cilat konkretisht kanë përfunduar për 8 ditë dhe 11 ditë.

- Çështja me nr. 18 regjistri rezulton se është regjistruar në datë 18.01.2022 por i ka kaluar gjyqtares me short 20.01.2022 dhe ka përfunduar me vendimin në datë 25.01.2022, pra brenda afatit ligjor 5 ditor. Për pasojë kjo çështje nuk përfshihet në çështjet e përfunduara jashtë afatit ligjor, duke qenë se kohëzgjatja e saj ka ardhur për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtares;

⁴⁹Në tabelën nr. 2, të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “*Pa palë kundërshtare*” rezulton që çështjet e gjykuara jashtë afatit ligjor me objekt “*Sigurim padie*” janë çështjet me nr.rendor 152 dhe 159.

Në çështjet me objekt “*Ndihmë juridike*”, nga 5 çështje, rezultojnë se 3 çështje janë gjykuar jashtë afatit 5 ditor,⁵⁰ të cilat konkretisht kanë përfunduar për 9, 7 dhe 10 ditë.

- Çështja me numër rendor 174, me numër akti 11, rezulton se është regjistruar në datë 02.02.2022 por i ka kaluar gjyqtares me short 03.02.2022 dhe ka përfunduar me vendimin në datë 11.02.2022. Vendimi është marrë për një afat prej 8 ditësh, duke tejkuluar afatin ligjor me vetëm 3 ditë.
- Çështja me numër rendor 176, me numër akti 46, rezulton se është regjistruar në datë 12.09.2022 por i ka kaluar gjyqtares me short 15.09.2022 dhe ka përfunduar me vendimin në datë 21.09.2022. Vendimi është marrë për një afat prej 6 ditësh, duke tejkuluar afatin ligjor me vetëm 1 ditë.

Tejkalime këto të cilat vlerësohet të jenë të papërfillshëm, duke konsideruar edhe ditët e pushimit javor, të cilat ndikojnë në përlllogaritjen e afatit.

Sa më sipër, numri i çështjeve të përfunduara tej afatit ligjor të gjykimit, pas analizës si më sipër, rezulton të jetë 6 çështje të gjykuara jashtë afatit ligjor. Duke iu referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (6 çështje) me numrin e çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (17 çështje), gjyqtarja **rezulton që të ketë gjykuar 35% të çështjeve tej afatit ligjor.**

Kjo përqindje e çështjeve jashtë afatit ligjor, sipas Metodologjisë pikëzohet me 6 (gjashtë) pikë. Në Metodologji, lidhur më këtë tregues, është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjitha burimeve të vlerësimit, nisur nga tregues të tillë si: kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarit, rritja e volumit të punës, apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës së tij, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Në rastin konkret, pavarësisht numrit të ulët të çështjeve për të cilat ligji parashikon afate ligjore gjykimi, rezulton se gjyqtarja ka pasur një ngarkesë të lartë çështjes në periudhën e vlerësimit prej 416 çështjesh, si dhe ka përfunduar 411 çështje.

KONKLuzioni

Duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, konkretisht:

- a) numrit të ulët të çështjeve të shqyrtuara, të cilat llogariten me afat ligjor (17 çështje), çka ndikon edhe raportin e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor me numrin e çështjeve për të cilat ligji parashikon afat ligjor; (nga 17 çështje në total, 6 çështje, me **mesatare** tejkalimi 47 ditë për çështjet me objekt “*Kundërshtim veprimesh përmbare*”);
- b) fakti që në 1 çështje (me objekt *kundërshtim veprimesh përmbare*), koha e shqyrtimit të saj është më e vogël se 45 ditë, brenda të cilës mund të përfundojë gjykimi i së njëjtës çështje në gjykatën e apelit. Ligji procedural parashikon për shkallën e parë shqyrtimin e ankimit ndaj veprimeve përmbare brenda 20 ditëve, si rregull

⁵⁰Në tabelën nr. 2, të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “*Pa palë kundërshtare*” rezulton që çështjet e gjykuara jashtë afatit ligjor me objekt “*Ndihmë juridike*” janë çështjet me nr.rendor 174, 176 dhe 177.

në dhomë këshillimi. Gjykatës i njihet mundësia e thirrjes së palëve kur e vlerëson të nevojshme. Por ligji nuk parashikon afat për gjykatën e shkallës së parë, sikundër bën në rastin e gjykimit në apel, për shqyrtimin e çështjes kur ajo kalon në seancë gjyqësore. Kjo situatë ligjore nuk mund të anashkalohet nga vlerësuesi, në rastet kur afati i gjykimi i çështjeve të kësaj kategorie, në shkallën e parë, tejkalon afatin 20 ditor, por është më i shkurtër se 45 ditë (**sikurse ka ndodhur në çështjen me numër rendor 120 të tabelës nr.1 ku pasqyrohen çështjet me palë kundërshtare, e cila është gjykuar për 22 ditë**);

- c) pamundësinë e respektimit në të gjitha rastet të afatit ligjor 20/ditor sipas nenit 610 të K.Pr.Civile, për shkak të veprimeve procedurale të nevojshme për t'u kryer në kuadër të gjykimit administrativ, me qëllim respektimin e të drejtave dhe detyrave procedurale të organit publik (*personit fizik apo juridik që ofron një shërbim publik*);

për këtë tregues, gjyqtarja pikëzohet më lart se niveli i pikëzimit që i përket përqindjes së çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit, pavarësisht se përqindja e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor rezulton 35%. Për pikëzimin e këtij treguesi, vlerësuesi bazohet në parimin e proporcionalitetit, objektivitetit, përballë detyrueshmërisë ligjore që një kategori çështjesh duhet të shqyrtohen brenda afateve të përcaktuara. Pavarësisht rrethanave konkrete që lidhen me kushtet e punës, numri relativisht i vogël i çështjeve me afat gjykimi (në total 17 nga të cilat 6 jashtë afatit) nuk justifikon një pikëzim maksimal, sepse gjyqtarja duhej të kishte treguar një shkallë më të lartë kujdesi në shqyrtimin me përparësi të këtyre çështjeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar përqindjes së çështjeve të gjykuara jashtë afatit ligjor dhe shkallës së përgjegjësisë së gjyqtarës, në lidhje me këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 12 pikë.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit viti 2022, duke iu referuar standardit minimal kohor 1 muajor të përcaktuar në vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD,⁵¹ rezulton se nga 394 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 193 prej tyre janë gjykuar tej këtij afati duke përbërë 48.98% të çështjeve të gjykuara jashtë standardit minimal kohor në fuqi.

Gjyqtarja në Formularin e Vlerësimit ka bërë prezent një sërë shkaqesh të cilat ndikojnë në kohëzgjatjen e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën administrative duke argumentuar se gjykimi administrativ është një gjykim i një natyre komplekse dhe shpesh herë i

⁵¹Në pikën 5 shkronja "c" të "Kritereve matëse të veprimtari së gjyqësore", miratuar me vendimin e KLD nr. 261/2 të vitit 2010, lidhur me standardin minimal kohor për gjykimin e çështjeve administrative, parashikohet se :” Standardi kohor i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari të gjykimeve brenda një afati kohor maksimal nga data e caktimit të gjyqtarit të çështjes si më poshtë: ...c. Gjykimet e mosmarrëveshje administrative në gjykatën e shkallës së parë, jo me tej se 1 muaj.”.

vështirë për t'u kryer brenda afateve të shpejta. Afati 30 ditë është një afat i pamundur për pjesën më të madhe të shqyrtimit të mosmarrëveshjeve administrative, në mënyrë objektive, për disa arsye si:

- ngarkesa e lartë në punë (Numri i çështjeve të shortuara dhe të gjykuara);
- sjellja e palëve ndërgjyqëse, kryesisht të organeve publike gjatë gjykimi dhe ndryshimet e shpeshta, që pësojnë në strukturë dhe funksion ato;
- legjislacioni në fushën e së drejtës publike është shumë i larmishëm, i detajuar me akte nënligjore, në përditësim të përhershëm dhe shpesh, praktikat administrative janë jo të njëjta të ndjekura prej organeve publike, gjatë procedurave administrative. Kjo situatë kërkon kohën e nevojshme, që për çdo çështje të studiohen aktet e paraqitura, baza ligjore, pretendimet e palëve, në mënyrë të detajuar;
- infrastruktura mbështetëse në burimeve njerëzore;
- mjetet e infrastrukturës teknike, gjithashtu ndikojnë në uljen e rendimentit;
- zhvillimi i një numri shumë të madh dhe kompleks të veprimeve procedurale dhe ndjekja që këto veprimeve të pasqyrohen saktë dhe në përputhje me ligjin procedural prej sekretarisë gjyqësore;
- Larmia dhe kompleksiteti i çështjeve në këtë lloj gjykimi bën që koha e studimit të çështjes, akteve të paraqitura dhe pretendimeve të palëve, bazës ligjore të referuar, si dhe arritja e një përfundimi nga unë si gjyqtare në lidhje me çështjen, të rritet. Secila nga çështjet ka specifikën e vet dhe për secilën duhet një kohë e nevojshme përgatitje dhe studimi. Kompleksiteti i çështjeve është një element tjetër që ndikon në kohën që i duhet gjyqtarit për të vendosur në lidhje me çështjen. Në gjykatën administrative gjykohen konflikte mes shoqërive tregtare dhe organeve tatimore dhe doganore të cilat paraqesin vështirësi në gjykimin e tyre sepse kanë shumë problematika në vetvete, të cilat kërkojnë secila kohën e tyre. Nëse do t'i referohemi statistikave do të konstatojmë se gjykimet në lidhje me kundërshtimet e akteve kanë përfunduar në një kohë optimale. Gjykimet që kanë zgjatur janë ato që kanë pasur nevojë për akte ekspertimi.
- Një arsye tjetër e cila ka zgjatur kohën e gjykimeve të zhvilluara për vitin 2022 ka qenë bojkoti i realizuar prej Dhomës Kombëtare të Avokatisë për periudhën Qershor –Shtator 2022.
- Përgjatë periudhës kohore të vitit 2022, gjyqtarja ka argumentuar se përveç se ka gjykuar çështjet administrative në Gjykatën Administrative Shkalla e Parë, Tiranë, ka kryer dhe detyrën e Zëvendës Kryetares së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, rrethanë e cila ka ndikuar në kohën e zhvillimit të gjykimit.

Lidhur me kohëzgjatjen e gjykimit në çështjet administrative, pavarësisht se ligji nr.49/2012 nuk parashikon afat gjykimi për kategori të caktuara çështjesh, përveç kërkesave të veçanta sipas objektit të tyre, parashikon afate për kryerjen e veprimeve procedurale prej momentit të shortimit të çështjes deri në përfundim të gjykimit.

Duke iu referuar parashikimeve të nenit 25 të ligjit nr.49/2012, në të cilin parashikohet afati 7 ditor për kryerjen e veprimeve paraprake, afatit maksimal 10 ditor për plotësimin e të metave të padisë për paditësin, afatit maksimal 10 ditor për depozitimimin e prapësimeve me shkrim dhe provave nga pala e paditur, afatit maksimal 20 ditor për kryerjen e ekspertimit në rast se vlerësohet i nevojshëm, afatit minimal 5 ditor për njoftimin e palëve për kryerjen e veprimeve si më sipër, rezulton se veprimet përgatitore

që duhet të kryejë gjyqtari në një çështje administrative me palë zgjatim mesatarisht 47 ditë.

Nëse do të zhvillohet seancë përgatitore për të qartësuar natyrën e mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 158/b të Kodit të Procedurës Civile, pas përfundimit të veprimeve përgatitore sipas nenit 25 të ligjit nr.49/2012, bashkë me kohën minimale të nevojshme për realizimin e njoftimeve të palëve, kjo fazë e gjykimit zgjat 15 ditë.

Pas zhvillimit të seancës përgatitore, caktimi i seancës gjyqësore, në referim të nenit 27 pika 1 të ligjit nr. 49/2012, duhet të jetë brenda afatit ligjor 15 ditor. Në rast se procesi gjyqësor do të zhvillohet brenda një seance gjyqësore dhe nuk do të ketë kërkesa të palëve për shtyrje të gjykimit, kryerjen e veprimeve të tjera procedurale që do të pasjellin shtyrje të seancës, duke marrë parasysh vetëm afatin 5 ditor të parashikuar nga neni 302 i K.Pr.Civile për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare të palëve, dhe afatin 5 ditor të parashikuar nga neni 308 për shpalljen e vendimit të arsyetuar nga gjykata, kohëzgjatja e gjykimit nga momenti i përfundimit të seancës përgatitore deri në shpalljen e vendimit do të ishte minimalisht 25 ditë.

Në tërësi, duke iu referuar afateve për zhvillimin e veprimeve procedurale si më sipër, **gjykimi i një çështje administrative do të përfundonte brenda një afati minimal prej 87 ditësh.** Ky afat minimal kohor për përfundimin e gjykimit të çështjes administrative, duke respektuar të gjitha hapat proceduralë të domosdoshëm për zhvillimit e gjykimit si dhe duke respektuar me rigorozitet afatet procedurale për kryerjen e tyre, është dukshëm më i gjatë se standardi minimal kohor orientues në fuqi.

Respektimi strikt i afateve të parashikuara nga ligji nr.49/2012 dhe Kodi i Procedurës Civile, sjell një kohëzgjatje gjykimi të çështjeve më shumë se 1 muaj nga ajo e përcaktuar si standard orientues, e si i tillë ky i fundit nuk ka kuptim të gjejë zbatim. Referuar afatit 87-ditor të llogaritur më lart, si kohë e domosdoshme për kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme, rezulton se nga 394 çështje të gjykuara për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, sipas një llogaritje matematikore, 115⁵² prej tyre kanë përfunduar përtej këtij afati.

Gjithashtu, duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore rezulton se në disa raste vonesa në shqyrtim ka ardhur si pasojë e lejes vjetore të kryer nga gjyqtarja në muajin gusht (35 ditë). Nëse në përllogaritjen e afatit të gjykimit nuk do të përfshihej periodha kur gjyqtarja ka qenë me leje vjetore, atëherë disa prej këtyre çështjeve do të kishin përfunduar brenda standardeve minimale kohor. Konkretisht:

- çështja me numër rendor 154, i është caktuar gjyqtares me short në datën 29.06.2022 dhe ka përfunduar në datën 05.10.2022 (98 ditë). Duke hequr

⁵²Në tabelën nr.1, çështjet me numër rendor 3-6, 9, 11, 12, 32-34, 38, 43, 45, 51-53, 57, 58, 63, 67, 69-72, 76, 77, 81, 84, 87, 88, 91, 94, 96, 98, 101, 102, 106, 107, 109, 110, 112, 117, 125, 127, 132, 137, 143, 144, 146, 149, 161, 162, 168, 170-172, 175, 178, 180, 182, 184-186, 188, 189, 191-193, 196, 200, 201, 204, 205, 209 kanë përfunduar brenda afatit minimal prej 87 ditësh

Në tabelën nr.3, çështjet me numër rendor 3-5 dhe 12 kanë përfunduar brenda afatit minimal prej 87 ditësh

- periudhën e lejes vjetore në vitin 2022 (35 ditë), kjo çështje do të kishte përfunduar për 63 ditë, pra brenda standardit minimal të pranuar prej 87 ditësh;
- çështja me numër rendor 159, i është caktuar gjyqtarës me short në datën 20.06.2022 dhe ka përfunduar në datën 17.10.2022 (119 ditë). Duke hequr periudhën e lejes vjetore në vitin 2022 (35 ditë), kjo çështje do të kishte përfunduar për 84 ditë, pra brenda standardit minimal të pranuar prej 87 ditësh;
 - çështja me numër rendor 165, i është caktuar gjyqtarës me short në datën 27.06.2022 dhe ka përfunduar në datën 24.10.2022 (119 ditë). Duke hequr periudhën e lejes vjetore në vitin 2022 (35 ditë), kjo çështje do të kishte përfunduar për 84 ditë, pra brenda standardit minimal të pranuar prej 87 ditësh;

Nëse në përllogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë standardit minimal kohor, do të përjashtoheshin edhe 3 çështjet e analizuara më sipër, të cilat, nëse do të zbritet periudha e lejes vjetore rezultojnë të përfunduara brenda afatit, rezulton se **nga 394 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 112 prej tyre ose rreth 28%.**

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, sipas një llogaritje vetëm matematikore, përqindja e mësipërme e çështjeve të përfunduara jashtë standardit minimal kohor, pikëzohet me 3 pikë. Por, referuar përsëri të njëjtit akt nënligjor, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, vlerësuesi mund të përcaktojë një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në pikëzim maksimal, duke marrë parasysh tregues të tjerë që lidhen me produktivitetin e gjyqtarit.⁵³ Në rastin konkret, sa i përket treguesit sasior të punës së gjyqtarës, rezulton se në vitin kalendarik 2022 gjyqtarja ka përfunduar në total 411 çështje në cilësinë e relatorit, nga të cilat 221 çështje janë me palë kundërshtare, çka tregon për një numër të lartë çështjesh të përfunduara, pavarësisht ngarkesës.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me:

- a) afatin e gjykimit të çështjeve administrative për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, duke pranuar si të tillë atë 87 ditor dhe jo 1 mujor;
- b) raportit të çështjeve të gjykuara tej afatit standard, me numrin total të çështjeve për të cilat zbatohet ky afat, i cili rezulton të jetë në masën 28%;
- c) vetëvlerësimin e gjyqtarës lidhur me shkaqet objektive që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimeve;
- d) treguesin sasior të punës gjatë periudhës së vlerësimit viti 2022, vit gjatë së cilit gjyqtarja ka përfunduar 411 çështje, nga të cilat me palë kundërshtare janë 221 çështje (*të pasqyruara në tabelën 1 dhe 3 të të dhënave statistikore*), duke tejkaluar me rreth 342% standardin sasior të punës për periudhën 10 mujore të

⁵³Në Metodologjinë e Pikëzimit, sa i përket këtij treguesi, parashikohet se:” *Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzimin maksimal”.*

vitit 2022, në të cilën ajo ka ushtuar dhe detyrën e zëvendëskryetares së gjykatës;

e) natyrën orjentuese dhe jo detyruese të këtyre standardeve kohore, ku hapësira e vlerësuesit është më e gjerë se treguesi i “Respektimit të afateve ligjore”, pavarësisht përqindjes së mësipërme, për këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë, pasi shqyrtimi i 28% të çështjeve jashtë standardit minimal 87 ditë, ka ardhur përgjithësisht për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës, si dhe rezultojnë se gjyqtarja, pavarësisht ngarkesës, ka përfunduar më shumë se 50% të standardit sasior në fuqi.*

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezultojnë se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi (1/muaj) sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykim, është më e gjatë se standardi për dy nga tre kategoritë e çështjeve. Krahasimi për efekt të vlerësimit, do të bëhet duke iu referuar standardit minimal kohor 87 ditë për çështjet me palë kundërshtare, referuar arsytimit të bërë më sipër në treguesin 2.A.b.

Referuar raportit analitik rezultojnë se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje për kategorinë:

- (i) “Administrative me palë kundërshtare” është **138 ditë**. Referuar të dhënave statistikore të dërguar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë evidentohet se çështjet me numër rendor 21, 31, 115 dhe 120, të pasqyruar në tabelën nr.1, kanë qenë të pezulluar, por pa përcaktuar afatin e pezullimit. Nëse nga përllogaritja e kohës mesatare që i dedikohet çdo çështje për këtë kategori do të përjashtonim 4 çështjet për të cilat gjykimi ka qenë i pezulluar, atëherë koha mesatare që i dedikohet çdo çështje do të rezultonte **114 ditë** (më e gjatë se standardi minimal kohor 87 ditë).
- (ii) “Administrative pa palë kundërshtare” është **19 ditë** (më e shkurtër se standardi minimal kohor në fuqi prej 1 muaj) dhe
- (iii) “Marrëdhënie pune” është **108 ditë** (më e gjatë se standardi minimal kohor 87 ditë).

Duke iu referuar arsytimit të mësipërm lidhur me standardin minimal që duhet të gjejë zbatim për gjykimin e të gjitha çështjeve administrative, rezultojnë se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, për dy nga tre kategoritë e çështjeve, është më e gjatë se afati 87 ditë.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë duke parashtruar se “Përgjatë periudhës kohore të vitit 2022, përveç se kam gjykuar çështjet administrative në Gjykatën Administrative Shkalla e Parë Tiranë prej datës 15.03.2022 unë kam kryer dhe detyrën e Zëvendës Kryetares së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Prej datës 10.05.2022 për shkak të

promovimit të Kryetarit të Gjykatës unë kam ushtruar këtë detyrë prej asaj date e në vijim. Rrjedhimisht, ka ndikuar në kohë e zhvillimit të gjykimit, kjo rrethanë. Një arsye tjetër e cila ka zgjatur kohën e gjykimeve të zhvilluara për vitin 2022 ka qenë bojkoti i realizuar prej Dhomës Kombëtare të Avokatisë për periudhën Qershor –Shtator 2023. Dispozita ligjore e germa “a” pika 1 neni 399/2 i K.Pr.Civile, në fuqi dhe e zbatueshme përgjatë periudhës kohore të vlerësimi, përcakton se, afati 1 vit, është afat i arsyeshëm për kohën e gjykimit administrativ në shkallë të parë. Përgjatë periudhës kohore, viti 2022 kam gjykuar gjithsej 416 (katërqind e gjashtëmbëdhjetë) çështje, nga ku 221 janë çështje me palë kundërshtare. Nga 221 çështje me palë kundërshtare 202 çështje janë gjykuar në një afat më të shkurtër se ai gjashtë muaj, 14 çështje janë gjykuar në një afat 6-12 muaj. Nga 221 çështje me palë kundërshtare, kam përfunduar tej afatit 1 vjeçar vetëm 5 prej tyre dhe vetëm 2 çështje mbi dy vjet. Në të dyja çështjet që është tejkualuar afati i gjykimit, mosmarrëveshjet kanë qenë komplekse është marr akt ekspertimi si provë, qëndrimi i palëve në gjykim ka sjell vonesa, pasi janë parashtruar kërkesave procedurale të ndryshme etj. Nga 190 çështje, pa palë kundërshtare kam përfunduar, jashtë afatit ligjor vetëm 2 prej tyre. Në çështjet që është tejkualuar afati i gjykimit, mosmarrëveshjet kanë qenë komplekse është marrë akt ekspertimi si provë, qëndrimi i palëve në gjykim ka sjell vonesa, pasi janë parashtruar kërkesave procedurale të ndryshme etj.”.

KONKLUZIONI

Mbështetur në të njëjtën analizë si në treguesin më sipër (treguesi “2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore”), duke konsideruar afatin 87 ditor si standard minimal kohor për efekte të krahasimit të kohës mesatare që i dedikohet çdo çështje, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është më e shkurtër se ky afat për 1 nga 3 kategoritë e çështjeve. Koha mesatare është më e gjatë se standardi për kategoritë e çështjeve “Administrative me palë kundërshtare” dhe “Marrëdhënie pune”, duke u tejkualuar ky afat respektivisht me 27 ditë dhe 21 ditë. Bazuar në të njëjtat argumente si për treguesin e “Plotësimin të standardeve minimale kohore”, si dhe duke vlerësuar kategorinë e çështjeve për të cilat ky standard rezulton i tejkualuar, tejkalimi me 27 apo 21 ditë është i papërfillshëm për ngarkesën e gjyqtarës, prandaj për këtë tregues gjyqtarja, bazuar në analizën logjike të të dhënave statistikore pikëzohet maksimalisht me 5 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje” gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, si raport mes numrit të çështjeve të përfunduara, me numrin e çështjeve të caktuara brenda vitit kalendarik, është 98.8%.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit përqindja e mësipërme (98.8%) pikëzohet me 8 pikë. Referuar përsëri të njëjtit akt nënligjor, pikëzimi për këtë tregues bëhet duke vlerësuar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Mbi këtë bazë, vlerësuesi mund të përcaktojë një shkallë më të lartë pikëzimi duke marrë parasysh tregues të tjerë që lidhen me produktivitetin e gjyqtarit, siç është në rastin konkret, treguesi sasior i punës së gjyqtarit. Sipas pikës 3 shkronja “c”, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, seksioni administrativ, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 150 gjykime çështjesh që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje administrative. Ndërkohë rezulton se gjyqtarja, prej datës 15.03.2022 ka ushtruar detyrën e zëvendëskryetares së gjykatës, për shkak të ngritjes në detyrë të kryetarit në detyrë. Për pasojë, për 10 muaj të vitit 2022, në referim të pikës 3, shkronja h) të aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve, standardi sasior i zbatueshëm është 60 çështje në vit, ose 50 çështje për 10 muaj (40 % e ngarkesës minimale të gjyqtarit të së njëjtës gjykatë). Nëse do t'i referohemi këtij standardi sasior, për vitin 2022, rezulton se gjyqtarja e ka tejkaluar standardin sasior me rreth 342% për periudhën 10 mujore të vitit 2022, në të cilën ajo ka ushtruar dhe detyrën e zëvendëskryetares së gjykatës.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësuar në tërësinë e tyre, si dhe të dhënave statistikore nga të cilat rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjatë gjithë vitit 2022, 411 çështje (nga të cilat 221 çështje janë me palë kundërshtare), rendimenti i përfundimit të çështjeve nga gjyqtarja, pavarësisht se rezulton të jetë 98.8%, pikëzohet me 10 pikë referuar Metodologjisë së Pikëzimit, pasi shkaqet që kanë ndikuar në rendimentin e gjyqtares lidhen me ngarkesën e punës gjatë vitit të vlerësimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 10 pikë, pasi rendimenti prej 98.8% i përfundimit të çështjeve ka ardhur përgjithësisht për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtares, sikundër është treguesi sasior i punës së saj (411 çështje të përfunduara me vendim, nga të cilat 221 çështje janë me palë kundërshtare) pra më shumë se treguesi sasior në fuqi.

2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se koha mesatare e arsytimit të vendimeve gjyqësore për kategori çështjesh, krahasuar me afatin ligjor 7 ditor të parashikuar në nenin 42, pika 3 të ligjit nr. 49/2012, është si më poshtë:

- Për çështjet të kategorisë “Administrative me palë kundërshtare” rezulton koha mesatare e arsytimit është 7.2 ditë, **pra më i gjatë** se afati procedural i

posaçëm prej 7 ditësh i parashikuar nga neni 42/3, i ligjit 49/2012.

- Për çështjet të kategorisë “Administrative pa palë kundërshtare” rezulton koha mesatare e arsytimit është 4.6 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural i posaçëm prej 7 ditësh i parashikuar nga neni 42/3, i ligjit 49/2012.
- Për çështjet të kategorisë “Marrëdhënie pune” rezulton koha mesatare e arsytimit është 8.75 ditë, pra më e gjatë se afati procedural i posaçëm prej 7 ditësh i parashikuar nga neni 42/3, i ligjit 49/2012.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë, duke parashtruar se: “Nga ana ime është bërë përpjeka maksimale për respektimin e afatit ligjor i cili duhet thënë se në shumë raste më ka vendosur në vështirësi për të ruajtur balancën e nevojshme mes cilësisë së arsytimit apo shpejtësisë së depozitimit të tij në sekretari. Afati shtatë ditor është një afat mjaft i shkurtër i cili është respektuar prej meje në pjesën më të madhe të rasteve duke patur parasysh ngarkesën e madhe në punë. Po kështu duhet të vlerësohet se ky afat i është referuar një ngarkese normale të punës së gjyqtarit administrativ, situatë e cila nuk përputhet me situatën faktike të gjykatës administrative. Pavarësisht afatit të depozitimit të vendimit sqaroj se ashtu sikurse ligji parashikon shpalljen e arsyetuar të vendimit nga ana ime u bëhen të dituar palëve në shpalljen e vendimit argumentet kryesorë, mbi të cilat kam bazuar vendimmarrjen. Nga ana ime është treguar përkushtim në shkallën më maksimale të mundshme dhe shfrytëzim ekstrem i kohës në dispozicion për të përmbushur detyrën brenda afateve të caktuara. Koha e punës ka qenë e pamjaftueshme për të përfunduar në kohë dhe me cilësi arsytimit e vendimeve duke bërë që të shpenzohet dhe kohë tej orarit zyrtar”.

Sipas Metodologjisë, për të pikëzuar këtë tregues, analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, duke zbatuar një koeficient jo më shumë se 20%.

Nga analiza e integruar e të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton:

- tejkalimi i afatit procedural 7 ditë për kategorinë e çështjet “Administrative me palë kundërshtare” është me 0.2 ditë, një tregues i papërfillshëm dhe i pakonsiderueshëm në një ditë të plotë;
- në çështjet e kategorisë “Administrative pa palë kundërshtare” koha mesatare e arsytimit është më e shkurtër se afati 7 ditor;
- tejkalimi i afatit procedural 7 ditë për kategorinë e çështjet “Marrëdhënie pune” është me 1.75 ditë, një tregues edhe ky i pakonsiderueshëm, duke konsideruar që në përllogaritje kanë ndikuar edhe pushimet javore.

Nga ana tjetër, afati 7 ditor i arsytimit të vendimit gjyqësor përfundimtar i përcaktuar në nenin 42 pika 3 të ligjit nr. 49/2012, është shumë i shkurtër krahasuar me afatin 20 ditor të arsytimit për vendimet gjyqësore civile sipas parashikimeve të nenit 308, parag 2 i Kodit të Procedurës Civile (pas ndryshimeve me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017).

Edhe pse ligji nr. 49/2012 përbën ligj të posaçëm dhe sipas nenit 1 pika 2 të tij, dispozitat e K.Pr.Civile zbatohen vetëm në rastet kur nuk parashikohet ndryshe në të, përsëri duket se pas ndryshimeve të K.Pr.Civile dhe shkaqeve që kanë çuar ligjvënësinë në përcaktimin e afatit 20 ditor të arsyetimit të vendimit gjyqësor, ka një mungesë harmonizimi mes qëllimit të parashikimit të këtij afati me afatin e arsyetimit të parashikuara në ligjin nr.49/2012. Duke marrë në konsideratë arsyetimin e mësipërm rezultojnë se koha e arsyetimit të vendimeve gjyqësore nga ana e gjyqtarës subjekti vlerësimi është më e shkurtër se tre kategoritë e çështjeve. Gjithashtu vlerësohet edhe ngarkesa në punë e gjyqtarës. Gjyqtarja rezultojnë se, gjatë vitit 2022 ka përfunduar në total 411 çështje, (nga të cilat 221 çështje janë me palë kundërshtare) pra më shumë se treguesi sasior në fuqi.

KONKLuzioni

Për sa më sipër, koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor për të tre kategoritë e çështjeve konsiderohet e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues pikëzohet me 15 pikë.

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive

Referuar tabelave me të dhëna statistikore dhe të dhënave që pasqyrohen në Raportin Analitik, rezultojnë se ka mungesë të të dhënave për numrin e seancave gjyqësore për të gjitha çështjet pasi këto të dhëna nuk gjenerohen në mënyrë elektronike. Sipas Metodologjisë së Pikëzimit, treguesi i numrit të seancave për çështje bëhet pjesë e vlerësimit etik dhe profesional kur statistikat mundësohen në rrugë elektronike. Nëse kjo nuk është e mundur, ky tregues për vlerësimin dhe zvarritjen e gjykimeve, identifikohet dhe vlerësohet vetëm për çështjet e zgjedhura me short.

Referuar sa më sipër, për vlerësimin e këtij treguesi, në mungesë të të dhënave për numrin e seancave për të gjitha çështjet, të dhënat e analizuara i referohen 5 dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim të cilat janë çështje me palë kundërshtare. Referuar Raportit Analitik, rezultojnë se rezultojnë se në 5 dosjet e përzgjedhura me short (duke përfshirë çështjen pa palë kundërshtare) rezultojnë se janë zhvilluar **24 seanca gjithsej, nga të cilat 16 seanca përgatitore dhe 8 gjyqësore**. Numri mesatar i seancave gjyqësore është **1.6 seanca**.

Gjyqtarja në vetëvlerësimin e saj, lidhur me këtë tregues ka parashtruar se pjesa më e madhe të çështjeve që ka gjykuar i ka përfunduar me një seancë gjyqësore, pasi janë

kryer të gjitha veprimeve procedurale të nevojshme, gjatë veprimeve përgatitore, që mund të jenë edhe në seancë përgatitore, e cila gjithashtu në shumtën e rasteve është vetëm një në numër. Për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, për të cilat është e nevojshme kryerja e aktit të ekspertimit, apo marrja e informacioneve zyrtare (hetimi gjyqësor i zhvilluar kryesisht) seanca përgatitore mund të jetë në numër dy ose tri. Lidhur me seancat jo produktive gjyqtarja ka argumentuar se janë shumë të rralla dhe ndodh, kryesisht, vetëm në rastin kur nuk realizohen njoftimet, në mënyrë efektive për palët ndërgjyqëse dhe përfaqësuesit ligjorë.

Sa i përket kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave gjyqësore joproduktive, duke iu referuar Raportit Analitik dhe akteve të dosjeve të përzgjedhura me short, rezulton se gjyqtarja subjekt vlerësimi ka mbikëqyrur dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët.

Konstatohet se nga ana e gjyqtarës merren të gjitha masat me qëllim shmangien e seancave joproduktive dhe numri mesatar i seancave në masën 1.6 seanca, vjen për shkak të respektimit të detyrimit ligjor për dhënien e kohës palëve për paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare.

KONKLUZIONI

Referuar sa më sipër, për treguesit e “*Numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i 5 çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është **1.6 seanca** dhe gjyqtarja në të gjitha çështjet (*me palë kundërshtare*) ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave gjyqësore joproduktive, planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të tyre.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi numri mesatar i seancave gjyqësore rezulton të jetë 1.6 seanca dhe gjyqtarja ka kryer veprimet e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.*

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor

Referuar Raportit Analitik dhe dosjeve të përzgjedhura për vlerësim, rezulton se gjyqtarja ka vënë në lëvizje çështjet duke zhvilluar veprimet përgatitore në dhomë këshillimi brenda një kohë shumë të shkurtër nga caktimi i tyre me short dhe në çdo rast brenda afatit ligjor 7 ditor nga data e shortit në përputhje me parashikimet e nenit 25, pika 1 të ligjit nr.49/2012.

Në veprimet përgatitore të zhvilluara pas caktimit të çështjeve me short, gjyqtarja kryen me korrektësi dhe në mënyrë të plotë veprimet procedurale të parashikuara në nenin 25, pika 1 të ligjit nr.49/2012 duke disponuar për njoftimin e padisë dhe akteve palës së paditur dhe kur është rasti edhe të Avokaturës së Shtetit, bashkë me njoftimin për paraqitjen e tyre brenda afatit ligjor 10 ditor, duke shoqëruar disponimin e gjykatës dhe njoftimin e palës me paralajmërimin për mospranimin e tyre në rast të mosparaqitjes në afat, në respektim të parashikimeve të nenit 25, pika 1, shkronja “b” të Ligjit nr. 49/2012. Në dosjet e vëzhguara, në çështjet me palë kundërshtare (dosja 1, 2, 3, 5 dhe 6) në 4 prej tyre (*me përjashtim të dosjes 3*) është vlerësuar nevoja për zhvillimin e seancës përgatitore për të qartësuar natyrën e mosmarrëveshjes objekt gjykimi.

Në një rast në të cilin kërkesëpadia përmban edhe kërkesën për sigurimin e padisë duke pezulluar efektet e aktit administrativ, gjyqtarja ka caktuar, seancë gjyqësore të posaçme për shqyrtimin e kërkesës, por e ka caktuar këtë seancë jashtë afatit 5 ditor të përcaktuar në nenin 28, pika 3 të ligjit nr. 49/2012, seancë e cila është zhvilluar në prezencën e palëve dhe në përfundim të të cilës gjyqtarja ka disponuar me vendim për pranimin e kësaj kërkesë.⁵⁴

Në një çështje e cila i përket kategorisë së çështjeve me palë kundërshtare, me objekt “Shfuqizim akti administrativ”, me vendimin e datës 12.09.2022 ka disponuar për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi duke urdhëruar njoftimin e palëve. Konstatohet se pavarësisht se është shqyrtuar çështja mbi bazën e akteve të paraqitura nga ana e palëve ndërgjyqëse, është mbajtur procesverbal (me sekretare gjyqësore) për evidentimin e provave mbi të cilat gjyqtarja disponon në lidhje me kërkesëpadinë. Seanca në dhomë këshillimi nuk është regjistruar audio, por është mbajtur procesverbali me shkrim i datës 19.10.2022, në të cilin janë pasqyruar si aktet bashkëlidhur kërkesëpadisë edhe aktet e paraqitura nga pala e paditur bashkëlidhur prapësimeve, të cilat janë listuar në mënyrë kronologjike. Në përfundim pasi ka shqyrtuar këto akte, gjykata ka vendosur për rrëzimin e kërkesëpadisë.⁵⁵

Seancat përgatitore janë zhvilluar në mënyrë korrekte dhe të plotë duke evidentuar në çdo rast verifikimin e paraqitjes së palëve, relativitetin lidhur me aktet e njoftimit të palëve dhe paraqitjen ose jo të tyre. Në rastet kur seanca përgatitore është zhvilluar në mungesë të palës së paditur, gjyqtarja, pasi ka dëgjuar palën paditëse, ka relatuar prapësimet me shkrim të paraqitura nga të paditurit dhe provat shkresore që janë paraqitur nga pala në mungesë, duke disponuar me vendim për zhvillimin e gjykimit në mungesë. Në seanca përgatitore janë shqyrtuar dhe është disponuar me vendim të ndërmjetëm, duke disponuar, bazuar në nenin 223 të K.Pr.Civile, për depozitimin e gjithë praktikës administrative të mbajtur në lidhje me veprimin administrativ të dënimit me gjobë, si dhe për plotësimin e të metës të konstatuar lidhur me mosparaqitjen e provave në formën e kërkuar nga ligji (*seanca 1 përgatitore e dosjes 1*). Gjithashtu, gjykata ka

⁵⁴ Shih dosjen 2, që i përket vendimi nr.463, datë 21.02.2022, nga vëzhgimi i së cilës rezulton se çështja i ka kaluar përmes shortit elektronik gjyqtares në datën 19.11.2021, ndërkohë seanca për shqyrtimin e kërkesës për sigurimin e padisë është mbajtur në datë 26.11.2021 (*jashtë afatit ligjor 5 ditor, të parashikuar në nenin 28, pika 3 të ligjit nr.49/2012*).

⁵⁵ Dosja nr.3 që i përket vendimit nr.2725, datë 19.10.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

disponuar bazuar në nenin 185/2 të K.Pr.Civile për shtyrjen e seancës përgatitore me qëllim komunikimin e palës paditëse kërkesën për shtim të objektit të padisë dhe në seancën përgatitore pasardhëse është disponuar me vendim të ndërmjetëm për pranimin e kërkesës për shtimin e objektit të padisë.⁵⁶

Pas zhvillimit të veprimeve të përcaktuara në nenin 158/b të K.Pr.Civile, në çështjet me palë kundërshtare, gjyqtarja ka disponuar për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore e cila në çështjet e vëzhguara përgjithësisht është caktuar brenda afatit ligjor 15 ditor të parashikuar në nenin 27 pika 1 të ligjit nr. 49/2012. Themë në përgjithësi pasi në një rast konstatohet se seanca gjyqësore është përcaktuar pas 23 ditësh, por konstatohet se shkak është bërë ngarkesa e madhe e gjyqtarës.⁵⁷ Urdhri për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, përmban elementët e përcaktuar në nenin 27, pika 2 të ligjit nr. 49/2012, si dhe paralajmërimin për pasojat e mosparaqitjes së provave para zhvillimit të seancës së parë gjyqësore, sipas përcaktimeve të nenit 27, pika 3 të ligjit nr.39/2012

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, mbajtur me regjistrim audio. Seancat gjyqësore rezultojnë të jenë zhvilluar në mënyrë korrekte duke ndjekur ecurinë procedurale sipas dispozitave të K.Pr.Civile dhe duke pasqyruar veprimet e kryera për verifikimin e paraqitjes së palëve dhe përfaqësuesve të tyre; relatimin e akteve të njoftimit dhe marrjen ose jo dijëni për palët që nuk janë paraqitur; disponimin me vendim të ndërmjetëm për zhvillimin e gjykimit në mungesë në rastet e mosparaqitjes së palëve pa shkaqe të përligjura; shpalljen e gjykatës; dhënien e fjalës palëve për kërkesa paraprake; deklarin e hapur të shqyrtimit gjyqësor; dhënien fjalën palëve për paraqitjen e parashtrimeve dhe provave; administrimin e provave; drejtimin dhe orientimin e debatit mbi provat, si dhe mbi elementë proceduralë të zhvillimit të gjykimit; dhënien e fjalës palëve lidhur me vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor pas zhvillimit të debatit mbi provat; deklarin e mbyllur të shqyrtimit gjyqësor; disponimin me vendim për kërkesat e palëve për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare duke i dhënë kohë sipas afatit procedural të përcaktuar në nenin 302 të K.Pr.Civile; dhënien e fjalës palëve për paraqitjen e diskutimit përfundimtar, tërheqjen e gjykatës për marrjen e vendimit dhe shpalljen e vendimit përfundimtar ose shtyrjen e seancës për shpalljen e vendimit të arsyetuar,⁵⁸ brenda afatit procedural të parashikuar në nenin 42 pika 2 të ligjit nr. 49/2012.

Në një rast, lidhur me disponimin me vendim të ndërmjetëm për kërkesat e palëve të paraqitura bashkë me padinë, gjyqtarja ka zbardhur të arsyetuar vendimin gjyqësor, duke e bërë pjesë të dosjes sikurse është rasti i vendimit për sigurimin e padisë.⁵⁹

⁵⁶Dosja nr.2 që i përket vendimit nr.463, datë 21.02.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

⁵⁷Çështja me nr.3209 vendimi, datë 01.12.2022 e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

⁵⁸Çështja që i përket vendimit me nr.1208, datë 19.04.2022 e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

⁵⁹Shih dosjen me nr.463 vendimi, datë 21.02.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

Drejtimi i seancave është zhvilluar në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre dhe, kur është rasti, edhe me arsyet e vendimmarrjes (*në rastet e disponimit për kërkesat e palëve lidhur me ndërgjyqësinë, shtyrjen e seancës, etj.*).

Në dosjet e vëzhguara seancat e planifikuara janë çelur përgjithësisht në orarin e caktuar, me përjashtim të ndonjë rasti të çeljes me vonesa të papërfillshme, shoqëruar me relativitetin e shkakut që ka shkaktuar vonesën. Veprimet përgatitore dhe seancat përgatitore janë dokumentuar rregullisht dhe në mënyrë të plotë në procesverbalin e mbajtur nga sekretarja gjyqësore ndërsa seancat gjyqësore janë dokumentuar nëpërmjet regjistrimit audio.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë, me efikasitet dhe duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 20 pikë.

2.C Aftësia e gjyqtarës për të administruar dosjen gjyqësore

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes

Nga vëzhgimi i dosjeve të 6 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se dosjet janë renditura në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori ndërthurur me veprimet procedurale të gjykatës. Renditja e dosjeve ndjek kryesisht të njëjtën linjë në të 6 dosjet e vëzhguara duke grupuar aktet sipas kategorisë së tyre.

Renditja e dosjes fillon me aktin e regjistrimit të çështjes në gjykatë, procesverbalin e shortit, kërkesëpadinë dhe provat e paraqitura nga pala paditëse, prapësimet dhe provat e paraqitura nga pala e paditur (*kur prapësimet janë paraqitur me shkrim*), kërkesat dhe parashtrimet me shkrim të palëve gjatë gjykimit, aktet e njoftimit, procesverbalet e seancave të veprimeve paraprake, seancave përgatitore dhe gjyqësore, vendimet e ndërmjetme të zbardhura, vendimin gjyqësor përfundimtar, aktet e njoftimit të vendimit dhe procesverbalin me shkrim ose audio të seancave gjyqësore. Mënyra e renditjes së akteve në dosje e bën atë lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë.

KONKLUZIONI

Në tërësi dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se në dosje ndodhen të gjitha aktet dhe dokumentacioni i administruar gjatë gjykimit. Në çdo dosje administrohen aktet shkresore të paraqitura nga palët ndërgjyqëse (kërkesëpatria, provat, prapësimet, kërkesat dhe konkluzionet përfundimtare të palëve kur janë paraqitur me shkrim), aktet e hartuara nga gjykata (aktet e shortit, njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e dokumentimit të veprimeve paraprake, seancave përgatitore dhe seancave gjyqësore, vendimet gjyqësore përfundimtare dhe të ndërmjetme kur ato janë zbardhur me vete, vendimet për pranimin e ankimit).

Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

KONKLUZIONI

Në tërësi, dokumentacioni i dosjeve të vëzhguara është i saktë dhe i plotë, nuk konstatohen mungesa aktesh dhe nuk konstatohet në dosje dokumentacion i cili nuk i përket çështjeve konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
97	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e

pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për gjyqtaren {...}, gjatë periudhës së vlerësimit nuk janë dhënë ose zbatuar masa disiplinore.

Sa i përket ankesave, për periudhën e vlerësimit vitit 2022, ndaj gjyqtares rezulton të jenë paraqitur 2 (dy) ankesa për të cilat, pas verifikimit, Inspektor i Lartë i Drejtësisë me vendimet nr. 1173/3 prot, datë 21.07.2022 dhe nr.3127/1 prot., datë 09.11.2023 ka vendosur arkivimin e tyre pas shqyrtimit fillestar. Lidhur me shkaqet e ankesave dhe rezultateve të verifikimit të tyre, referuar materialeve të dërguara nga ILD, rezulton si më poshtë:

I- Ankesa e shtetasit L.Ç, regjistruar në ILD me nr. 1173 prot, datë 06.05.2022, konsiston në pretendime lidhur me vendimmarrje të padrejtë, në çështjen administrative të përfunduar me vendimi nr.80-2021-473, datë 01.03.2021, në të cilën gjyqtarja ka qenë në cilësinë e anëtares së trupit gjykues. Me vendimin nr.1173/3 prot., datë 21.07.2022 ILD ka vendosur arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së ankuesit L.Ç., ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistratëve A.A, S.Gj dhe {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke arsyetuar se ankesa nuk përmbush kriterin e pranueshmërisë, referuar nenit 120, pika 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

II- Ankesa e shtetasit B.T. e regjistruar në ILD me nr.1443 prot., datë 24.05.2022 konsiston në pretendimet për vendimmarrje në kundërshtim me ligjin në çështjen administrative të përfunduar me vendimin nr.1332, datë 27.04.2022. ILD, pas shqyrtimit fillestar të ankesës, ka vendosur me vendimin nr.3127/1prot., datë 09.11.2023 për arkivimin e ankesës ndaj veprimtarisë së magjistrates {...} me arsyetimin: *“Nga shqyrtimi i ankesës dhe pretendimeve të paraqitura konstatohet se nuk ngrihen dyshime të arsyeshme se sjellja apo veprimet e magjistratit znj. {...} janë të natyrës së tillë që të përbejnë shkelje disiplinore sipas parashikimeve të bëra nga nenet 101, 102, 103 dhe 104 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Për rrjedhojë, vlerësohet se ankesa nuk plotëson kriteret e pranueshmërisë referuar nenit 120, pika 1, shkronja “d” dhe “dh” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.*

Sa më sipër, në lidhje me këtë tregues nuk rezultojnë të dhëna, për cenimin e etikës në punë të gjyqtares subjekt vlerësimi.

Gjyqtarja në Formularin e Integruar të Vlerësimit i kanë vlerësuar shumë të larta aftësitë e saj në drejtim të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

KONKLUZIONI

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna që mund të tregojnë cenimin e etikës apo përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtares, shfaqje të sjelljeve që tregojnë mungesë respekti, vetëpërbajtje, ndjeshmërie, vëmendje, apo qasje të papërshtatshme dhe ofensive, gjatë ushtrimit të detyrës. Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk ka shfaqur sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares në lidhje me treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 35 pikë.

3.B Integriteti i gjyqtares

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjteti

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, rezulton të jenë regjistruar pranë ILD 2 (dy) ankesa, të trajtuara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimet nr. 1173/3 prot, datë 21.07.2022 dhe nr.3127/1 prot., datë 09.11.2023, në të cilat është vendosur arkivimi pas shqyrtimit fillestar, për shkaqet e referuar në analizën e treguesit më sipër.

Nga tërësia e fakteve të parashtruar dhe të analizuar në vendimet e ILD, nuk rezultojnë të dhëna për cenim të etikës apo elementë të tjerë që ndikojnë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtares, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjtetin dhe pritshmërinë e publikut.

Sa i përket masave disiplinore të dhëna rezulton se nuk është dhënë asnjë masë disiplinore për gjyqtaren {...} për periudhën 01.01.2022-31.12.2022.

Në raportin e ILDKPKI, përcjellë në KLGJ me shkresën nr. 651/23 prot., datë 27.07.2023, lidhur me deklarinë e pasurisë, konkludohet se: “*Deklarimi i pasurisë është i saktë dhe në përputhje me ligjin; ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklarinë të rremë dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit*”.

Gjyqtarja, lidhur me këtë tregues, e ka vlerësuar aftësinë e saj në nivel shumë të lartë.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indice që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtares, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim apo çdo sjelle tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtares.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të cenojnë integritetin e gjyqtares, gjyqtarja pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjellëve të pahijshme apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

Shkalla e integritetit të gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e integritetit të gjyqtares në lidhje me treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.

3.C Paanësia e gjyqtares

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese

Nga analiza e burimeve të vlerësimit pasqyruar në Raportin Analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve të administruara në dosjet e gjykimit, si dhe të dhënave nga vetëvlerësimi i gjyqtares.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e integritetit të gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares në lidhje me treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës

Sipas tabelës përmbledhëse me të dhënat statistikore për sasinë, shpejtësinë, përjashtimet dhe heqjet dorë nga gjykimi, për vitin 2022, të përcjellë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë rezulton se për gjyqtaren {...}, ka pasur 3 kërkesa për përjashtim, të cilat janë rrëzuar të gjitha. Gjithashtu, sipas të dhënave statistikore rezulton se subjekti i vlerësimit ka hequr dorë në 21 çështje, nga të cilat 20 kërkesa janë pranuar dhe 1 kërkesë është rrëzuar.

Në tërësi, referuar dhënave burimore për ekzistencën e numrit të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtim (nga të cilat asnjë nuk është pranuar), numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës është i pakonsiderueshëm.

Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër për efekt të Metodologjisë së Vlerësimit është “I pakonsiderueshëm”.

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja {...}, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarës për të qartësuar kërkimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor, konstatohet se komunikimi i saj është

i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilat pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre. Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë, koncize dhe duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

Gjyqtarja lidhur me këtë tregues e ka vlerësuar aftësinë e saj në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësi në proces, duke treguar kujdes për të qenë e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale për të cilat gjyqtarja vihet në dijeni për shkak të funksionit. Në çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton të ketë pasur të dhëna me karakter sensitiv apo personal. Gjithashtu, nga burimet e tjera të vlerësimit nuk ka asnjë të dhënë apo indice për cenim të konfidencialitetit apo të dhënat personale të palëve dhe pjesëmarrësve në gjykim.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “E lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indice për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues duke evidentuar se ka disponibilitet maksimal për të bashkëpunuar me kolegët, qoftë për sa i përket çështjeve ligjore ashtu edhe për sa i përket çështjeve organizative të Gjykatës, lidhur me ndarjen e sallave dhe orareve të seancave, apo çdo ndihmë tjetër që i është kërkuar. Gjithashtu gjyqtarja ka argumentuar se ka shfaqur disponibilitet për të ndarë me koleget përvojën e përftuar në aktivitetet e ndryshme trajnuese, si brenda dhe jashtë vendit ku kanë qenë së bashku. Në rastet kur ka qenë vetëm në trajnime është përpjekur që materialet dhe njohuritë e përfituara t'i ndaj me ta në mbledhjen e gjyqtarëve.

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezultojnë të dhëna negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, ndërkohë që gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë duke parashtruar se sjellja me administratën gjyqësore ka qenë korrekte dhe respektuese. Gjyqtarja ka argumentuar se përpiqet të ofrojë ndihmën për kuptimin e duhur të detyrave të ngarkuara, sa herë që i kërkohej dhe ka shprehur gatishmërinë për të ndihmuar këdo që ka nevojë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me administratën gjyqësore, është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtares për t’u angazhuar në veprimtari të tjera

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtares në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja {...}, gjatë periudhës së vlerësimit 01.01.2022-31.12.2022, ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e ekspertës, lehtësueses dhe pjesëmarrëses. Konkretisht, rezulton se gjyqtarja {...} është angazhuar në aktivitete trajnuese si më poshtë:

- (i) Në cilësinë e ekspertës në Programin e Formimit Vazhdues në 2 (dy) aktivitete trajnuese të zhvilluara në 2 (dy) ditë trajnim;
- (i) Në cilësinë e lehtësueses në Programin e Formimit Vazhdues në 2 (dy) aktivitete trajnuese të zhvilluara në 2 (dy) ditë trajnimi;
- (ii) Në cilësinë e pjesëmarrëses në Programin e Formimit Vazhdues në 1 (një) aktivitet trajnues të zhvilluara në 1 ditë trajnimi.

Duke iu referuar nenit 55, pika 9 të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës, pjesëmarrja në programimin e trajnimit vazhdues në cilësinë e ekspertit, lehtësuesit ose moderatorit ka vlerë edhe për efekt të përmbushjes së detyrimit për ndjekjen e programit të trajnimit vazhdues, duke u përlloritur 1 ditë pjesëmarrje si ekspert e barabartë me 2.5 ditë si pjesëmarrës, 1 ditë pjesëmarrje si lehtësues me 2 ditë si pjesëmarrës dhe 1 ditë si moderator me 1.5 si pjesëmarrës. Referuar këtij parashikimi, rezulton se gjyqtarja {...}, gjatë periudhës njëvjeçare të vlerësimit ka marrë pjesë në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës për 10 ditë trajnimi.

Sipas parashikimeve të nenit 5, pika 3 të Ligjit për Statusin, *periudha e formimit vazhdues duhet të jetë: a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve; b) jo më shumë se 40 ditë në vit dhe 200 ditë gjatë pesë viteve.* Në rastin konkret gjyqtarja ka marrë pjesë në 5 aktivitete trajnuese të shtrira në 10 ditë trajnimi, brenda kufijve minimale dhe maksimalë (5 deri në 40 ditë në vit) të përcaktuara nga Ligji për Statusin, duke përmbushur detyrimin ligjor për pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese të përshtatshme për funksionin e saj dhe që i përkasin fushës së veprimtarisë së saj pasi rezultojnë të jenë aktivitete me tema të së drejtës administrative dhe gjykimit administrativ.

Jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës gjyqtarja ka marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga:

- i) IRZ në bashkëpunim me KLGJ, në datat 26-30 shtator 2022, vizitë studimore me temë “Fuqizimi i gjyqësorit administrativ efektiv dhe eficient në Shqipëri”, në Dyseldorf, Gjermani, për të cilën gjyqtarja ka vënë në dijeni Këshillin me shkresën nr.8362 prot., datë 19.08.2022, protokolluar në KLGJ me nr.4367/1, datë 19.08.2022.
- ii) EJTN, institucion i njohur ndërkombëtarisht për trajnimin e gjyqtarëve në kuptim të nenit 5 pika 4 të Ligjit “Për Statusin”, zhvilluar në Kromeriz, Çeki në datat 21-25 nëntor 2022. Lidhur me pjesëmarrjen në këtë trajnim rezulton se gjyqtarja ka njoftuar me shkresën nr.11199 prot., datë 14.11.2022, protokolluar në Këshill me nr.5946 prot., datë 14.11.2022.

KONKLUZIONI

Nga analiza e të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në 5 aktivitete trajnuese të shtrira në 10 ditë trajnimi, si dhe në 2 aktivitete trajnuese ndërkombëtarë të shtrirë në 7 ditë trajnimi, brenda kufijve minimale dhe maksimale (5 deri në 40 ditë në vit) të përcaktuara në Ligjin për Statusin.

Pjesëmarrja e gjyqtarës në trajnime dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, pjesëmarrja e gjyqtarës në aktivitetet trajnuese të Sh.M dhe atyre ndërkombëtare është 17 ditë në vit (brenda kufijve ligjore 5-40 ditë në vit), duke u pikëzuar me 20 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarës për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe dosjes personale të gjyqtarës {...}, evidentohen të dhëna në lidhje me këtë tregues si më poshtë vijon:

Referuar dosjes personale të gjyqtarës subjekt vlerësimi rezulton se me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.316, datë 22.07.2021 “Për caktimin e trupës së gjyqtarëve udhëheqës për periudhën 2021-2024”, të përditësuar me vendimin nr.242, datë 30.06.2022 gjyqtarja {...} është miratuar si gjyqtare udhëheqëse për periudhën 2017-2020. Me vendimin nr. 315, datë 22.07.2021 “Për caktimin e gjykatave dhe gjyqtarëve udhëheqës gjatë praktikës profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2021-2022” të ndryshuar dhe vendimin nr. 252, datë 07.07.2022 “Për caktimin e gjykatave dhe gjyqtarëve udhëheqës gjatë praktikës profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2022-2023”, të ndryshuar, janë caktuar pranë gjyqtarës {...} për mentorim kandidatët për magjistratë z.Ledio Sali (nëntor 2021- shkurt 2022), z.Elis Dine (mars - qershor 2022), znj. Ina Yzellari (korrik - tetor 2022), znj.Elona Mertiri (korrik - tetor 2022), znj. Dorentina Mulaj (nëntor 2022- shkurt 2023) dhe znj. Entela Selmanaj (nëntor 2022- shkurt 2023).

Referuar informacionit të përcjellë prej Shkollës së Magjistraturës me shkresën nr. 720/2 prot., datë 13.10.2020 rezulton se gjyqtarja {...} ka marrë pjesë me cilësinë e ekspertes dhe lehtësueses për trajnimin e gjyqtarëve në trajnimin me temë:

- i. “Dëmi kontraktor që shkaktohet nga mospërbushja e kontratës ose nga zgjidhja e saj. Kontratat administrative dhe dëmi i shkaktuar prej mos përbushjes së tyre apo zgjidhjes”, trajnim i zhvilluar në datën 4 shkurt 2022 (lehtësuese/prezent gjatë gjithë ditës së trajnimit).
- ii. “E drejta për informim dhe mbrojtja e të dhënave personale. Ndikimi i legjislacionit të ri të mbrojtjes së të dhënave personale në punën e gjyqtarëve, prokurorëve dhe nëpunësve të caktuar për marrëdhëniet me publikun”, trajnim i zhvilluar në datën 2 mars 2022 (lehtësuese/prezent gjatë gjithë ditës së trajnimit).
- iii. “Roli i mentorëve në trajnimin e magjistratëve”, trajnim i zhvilluar në datën 19 shtator 2022 (eksperte/prezent gjatë gjithë ditës së trajnimit)
- iv. “Kontratat administrative. Forma e tyre. Zgjatja në heshtje e kontratave administrative. Problemet e hasura në praktikën gjyqësore”, trajnim i zhvilluar në datën 9 dhjetor 2022 (eksperte/prezent gjatë gjithë ditës së trajnimit).

Referuar vlerësimit të gjyqtares, në formularin e integruar të vlerësimit gjyqtarja ka deklaruar se me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.316, datë 22.07.2021, përditësuar me vendimin nr.242, datë 30.06.2022, në listën e miratuar, është caktuar si mentore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për periudhën kohore 2022. Gjatë kësaj periudhe ka ndjekur praktikën profesionale dhe paraprofesionale të një numri të konsiderueshëm kandidatësh për magjistratë, ku në disa raste pranë saj kanë ndjekur praktikën më shumë se një magjistrat duke bërë që angazhimi i saj të dyfishohet. Gjithashtu, parashton se është angazhuar në cilësinë e ekspertes dhe lehtësueses në Shkollën e Magjistraturës.

Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se pikëzimi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë, dhe 2 pikë të tjera iu shtohen në vlerësim gjyqtarëve që e kryejnë këtë veprimtari njëkohësisht me veprimtarinë gjyqësore, pavarësisht nga frekuenca e angazhimit.

KONKLUZIONI

Sa më sipër, për gjyqtaren {...} duke qenë se gjatë periudhës së vlerësimit ka qenë në cilësinë e ekspertes dhe lehtësueses në trajnimin e gjyqtarëve pranë Shkollës së Magjistraturës, si dhe me vendimet nr.316, datë 22.07.2021, përditësuar me vendimin nr.242, datë 30.06.2022 rezulton se gjyqtarja {...} është miratuar si magjistrate gjyqtare udhëheqëse për periudhën 2021-2024, duke iu caktuar edhe gjyqtarë për mentorim për vitin 2022, ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

Disponueshmëria e gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata

Referuar të dhënave burim vlerësimi, rezulton se në lidhje me këtë tregues me vendimin e Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës nr. 27, datë 23.09.2021 "Për miratimin e listës së pedagogëve të jashtëm, pedagogëve në dispozicion të vitit të parë dhe specialistëve të vitit të dytë, në programin e formimit fillestar për vitin akademik 2021-2022" dhe vendimi të datës 27.09.2022, gjyqtarja subjekt vlerësimi është caktuar si pedagoge në dispozicion për lëndën e “E drejtë tregtare”, por nuk ka të dhëna nëse gjyqtarja efektivisht e ka ushtruar këtë funksion.

Nga ana tjetër rezulton se gjatë periudhës së vlerësimit gjyqtarja {...} është angazhuar si pedagoge e jashtme në Universitetin e Tiranës, për vitin akademik 2022-2023, semestri i parë, në lëndën “Etikë profesionale në drejtësinë penale”. Për këtë veprimtari jashtë funksionit gjyqtarja ka njoftuar Këshillin me shkresën nr.11308 prot., datë 14.11.2022, protokolluar në KLGJ me nr.5962, datë 15.11.2022. Bashkëlidhur formularit gjyqtarja ka paraqitur në cilësinë e provës, vërtetimin datë 20.12.2022 të Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja ka deklaruar se gjatë vitit 2021-2022 është angazhuar në cilësinë e ekspertes në projektin për realizimin e një “Udhëzuesi për një rol aktiv të gjyqtarëve në menaxhimin e çështjeve” , të financuar nga OSCE, ku lidhur me këtë veprimtari ka nënshkruar edhe kontratën no.2021/131 PO:610322, datë 08.10.2021, e cila ka vijuar zbatimin e saj edhe në vitin 2022. Bashkëlidhur formularit gjyqtarja ka paraqitur “Draft udhëzues për një rol aktiv të gjyqtarëve në menaxhimin e çështjeve”. Kjo e dhënë rezulton edhe nga informacioni i dërguar nga gjyqtarja me shkresën nr.138 prot., datë 12.01.2023, në kuadër të veprimtarive jashtë funksionit të realizuara gjatë vitit 2022.

Gjithashtu, gjyqtarja ka deklaruar se që prej vitit 2019 ka marrë pjesë në Asamblenë e Forumit të Grave Gjyqtare Shqiptare (FGGJSH), ku në kuadër të objektit dhe qëllimit të forumit ka qenë pjesëmarrëse në disa projekte të realizuara prej forumit për organizmin e trajnimeve për mosdiskriminim gjinor dhe ligjin për mbrojtjen nga dhuna të grave dhe fëmijëve, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, por nuk rezulton që gjyqtarja bashkëlidhur formularit të ketë paraqitur prova për të provuar angazhimin dhe kontributin e saj në këto aktivitete.

Po kështu, gjyqtarja ka deklaruar se ka marrë pjesë në workshop me temë “*Adjudication of environmental issues (Gjykimi i çështjeve mjedisore)*” të zhvilluar nga CEELI Institute, në Pragë, Çeki, në datat 02-03 shtator 2022, për të cilën ka realizuar një prezantim lidhur me çështjet mjedisore. Lidhur me pjesëmarrjen në këtë aktivitet rezulton se gjyqtarja ka njoftuar Këshillin me shkresën nr.8326 prot., datë 19.08.2022, protokolluar në KLGJ me nr.4367/1 prot., datë 19.08.2022.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, për pikëzimin e këtij treguesi, vlerësohet dedikimi i kohës dhe përpjekjeve të gjyqtarit për përmirësimin e sistemit gjyqësor në mënyra të ndryshme. Këtu përfshihen: fjalimet publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efikasitetit; kontribute në hartimin e legjislacionit; aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe interesash të ndryshëm me qëllim rritjen e cilësisë të gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike.

Duke marrë parasysh se pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët e fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë. Një ose dy pikë të tjera iu shtohen në vlerësim gjyqtarëve që kryejnë këto veprimtari njëkohësisht me veprimtarinë gjyqësore, duke marrë parasysh sasinë dhe cilësinë e angazhimit, shkallën e pjesëmarrjes së gjyqtarit, ndikimin në veprimtarinë specifike dhe shtrirjen ndërkombëtare të angazhimit, si dhe çdo e dhënë tjetër që del nga burime vlerësimit të këtij treguesi.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në këtë periudhë vlerësimi, në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë apo aktivitete të tjera.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në treguesin “Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata” gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtarës në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, gjyqtarja ka shpjeguar në vetëvlerësimin e saj se në qershor të vitit 2022 ka mbrojtur temën e doktoraturës me disertacionin “Përgjegjësia penale e personave juridikë në veprat penale në fushën e mjedisit”, për të cilën është vlerësuar me 98 pikë për dhënien

e gradës shkencore, me vendimin e jurisë nr. 282 datë 30.06.2022. Bashkëngjitur formularit të vetëvlerësimit gjyqtarja ka depozituar vendimin nr. 282 dt. 30.06.2022, nga rezulton se pas procedurës së mbrojtjes dhe votimit, juria ka vlerësuar “shumë mirë” me pikët 98. Një kopje e disertacionit të mbrojtur i bashkëngjitet gjithashtu formularit të vetëvlerësimit të gjyqtarës. Mbrojtja e doktoraturës është kryer pas realizimit të publikimeve shkencore dhe pjesëmarrjes në konferenca shkencore.

Neni 77 i ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” përcakton se “*Studimet e doktoratës ndërtohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor në fushat e përcaktuara nga njësia bazë ose njësia kryesore. Ato kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtaritë krijuese”.*

Pika 2 e VKM 112/2018 “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “profesor i asociuar” dhe “profesor” parashikon :2. **Grada shkencore “doktor” fitohet pas mbrojtjes me sukses të tezës së disertacionit**, në përfundim të studimeve të doktoratës në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, sipas kriterëve dhe brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.

Në vijim në VKM e mësipërme përcaktohet : “.... 7. Kandidati harton disertacionin sipas formatit të miratuar në rregulloren e ciklit të tretë të studimeve. Disertacioni duhet të sjellë risi teorike dhe/ose empirike në fushën përkatëse të kërkimit, si dhe të jetë një kontribut në avancimin e njohurive shkencore. Disertacioni hartohet në gjuhën shqipe dhe një përmbledhje e tij (2000–4000 fjalë) në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht, në format të shtypur dhe elektronik. Disertacioni miratohet nga udhëheqësi shkencor përpara dorëzimit. 8. Kandidati dorëzon disertacionin, siç përcaktohet në pikën 7 të këtij kreu, së bashku me dosjen, pranë drejtuesit të njësisë kryesore, i cili ia përcjell për vlerësim njësisë bazë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e dorëzimit. Pas vlerësimit nga njësia bazë, disertacioni dhe dosja e kandidatit i përcillen Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”, brenda 30 (tridhjetë) ditëve. Komisioni, nëse e vlerëson pozitivisht dosjen, brenda 30 (tridhjetë) ditëve ngre jurinë për vlerësimin e disertacionit. Juria cakton datën e mbrojtjes së disertacionit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga formimi i saj. Disertacioni prezantohet para jurisë, e cila e vlerëson atë. Juria harton raportin e vlerësimit dhe ia dërgon Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”, i cili, brenda 10 (dhjetë) ditëve, merr vendimin për dhënien e gradës shkencore “doktor” dhe ia përcjell për procedura të mëtejshme drejtuesit të njësisë kryesore....

Neni 18/5 i Rregullores “Për organizimin e programeve të studimit të Doktoraturës në Universitetit e Tiranës”, të miratuar me vendimin 08, datë 26.04.2021 lidhur me mbrojtjen e doktoraturës përcakton se “Pas mbrojtjes së doktoraturës, njësia kryesore përcjell një kopje të disertacionit në Bibliotekën Kombëtare, një kopje në bibliotekën shkencore të njësisë kryesore dhe një kopje në formatin elektronik të Universitetit të Tiranës.

Ndërsa neni 22, i po kësaj rregulloreje, lidhur me etikën e punës kërkimore, në pikën 9 të tij përcakton se “Pronësia intelektuale, e drejta e autorit për punimin (si dhe për çdo material të botuar), mbrohet me ligj i së drejtës të autorit dhe akte të tjera të zbatueshme në këtë drejtim. Shënimi për rezervimin e së drejtës së autorit, simboli përkatës ©, emri i zotëruesit të autorësisë, viti i punimit duhet të vendosen në faqen, që vjen pas titullit të punimit”.

KONKLUZIONI

Disertacioni i hartuar nga gjyqtarja me qëllim marrjen e gradës shkencore “Doktor”, i vlerësuar nga juria prej 5/anëtarësh me tituj akademik, një anëtar Prof.Dr; 2 anëtarë Prof.Asoc.Dr dhe 2 anëtarë Prof.Dr, përbën kërkim shkencor dhe është kontribut në avancimin e njohurive shkencore, i barasvlershëm me botimin shkencor, madje me disa artikuj shkencorë të marrë së bashku. Ky disertacion në kuptim të nenit 77, shkronja “gj” dhe neni 86, pika 2 të Ligjit për Statusin, është tregues i ngritjes profesionale të gjyqtarit. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, tipologjisë dhe impaktit të kërkimit shkencor, çka ka sjellë përfshirjen e lëndës “E drejta e mjedisit” në kurikulën e re të Shkollës së Magjistraturës për vitin 2023, ku sipas informacionit të dërguar nga SHM znj. {...} është titullare e kësaj lënde, për gjyqtaren {...} ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

***Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në treguesin “Publikime ligjore akademike” rezulton angazhim i gjyqtarës dhe për këtë shkak pikëzohet me 5 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	97	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	100	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	397	Shkëlqyeshëm

PROPOZIME DHE REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93 pika 5 shkronja “ç” të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuar dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtarja {...} të vazhdojë të mbajë në konsideratë angazhimin e saj në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit të saj për përmirësimin e sistemit gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

SHTOJCA 1

**KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE
NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTAREN {...}
PERIUDHA E VLERËSIMIT 1 JANAR 2022- 31 DHJETOR 2022**

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES			Pikët total	Niveli i vlerësimit	
			100	Shkëlqyeshëm	
Treguesit	Burimet	Shkalla e aftësisë	Pikët	Të dhëna për metodologjinë	
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
B. Arsytimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	15	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë

	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES

Pikët total

Niveli i vlerësimit

97

Shkëlqyeshëm

Tregues	Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia	
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	11-20%	12	Jashtë afatit: Mbi 40 % - 3 pikë 31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10%	5	Jashtë afatit: Mbi 40 % - 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë

	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve	5	Koha mesatare: Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë
	ç.Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Mbi +99 %	10	Tej standardit : Nën 81 %- 2 pikë Mbi 81-87 % - 4 pikë Mbi 87- 93 % - 6 pikë Mbi 93-99 % - 8 pikë +99% - 10 pikë
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve	15	Koha mesatare: Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë

					Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë
B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	1. Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	1-3 seanca por shkallë e lartë e aftësisë	15	Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtarit: Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	5	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë

	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	35	Shkalla e etikës në punë e gjyqtarit: E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
B. Integriteti i gjyqtarit	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI	Shumë e lartë	40	Shkalla e integritetit të gjyqtarit : E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë
C. Paanësia e gjyqtarit	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë	10	Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë

					Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsiderueshëm	15	Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit: Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Pikët total

Niveli i vlerësimit

100

Shkëlqyeshëm

Tregues	Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia	
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë	25	Qartësia dhe transparenca e komunikimit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	I lartë	15	Respektimi i konfidencialitetit: I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i	Shumë e lartë	15	Shkalla e komunikimit: E dobët – 3 pikë

	përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave			Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	10	Shkalla e komunikimit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtari	5-40 ditë (Periudha 1/vjeçare)	20	Pjesëmarrja e gjyqtarit: (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4
	b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtarit 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të gjyqtarit	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të tij	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

